

BIBLIOTEKA

314-31

Z.47

Ridvan Dibra

Nudo

Roman



ÇABEJ
MCM

8541-31
047

Ridvan Dibra

Nudo

roman

PERPUSTAKA E
BENJANIS GIBOKASTER
N. 54066

MÇMÇABEJ

1

Të dielën e fundit të gushtit, Alfred D., njëri prej artistëve më në zë të Qytetit, mori një telegram, sipas të cilit duhet të paraqitej «urgjentisht» në Drejtorinë e Përgjithshme të Konvikteve. Mospërfillës në përgjithësi ndaj çdo gjëje që lidhej me Shtetin, Alfredi edhe kësaj radhe nuk u befasua aspak për ekzistencën e një drejtorie të tillë absurde në një qytet që s'kishte më shumë se dy-tre konvikte. Befasues, i çuditshëm e i pakuptimtë ishte për të vetëm telegrami, sipas të cilit duhet të paraqitej «urgjentisht» në atë drejtori. E ç'lidhje mund të kishte ai – një skulptor i papunë – me Drejtorinë e Përgjithshme të Konvikteve? Hamendësoi disa variante. Ndoshta e porosisnin për ndonjë punë tani në prag të vitit të ri shkollor, ndonjë prej atyre punëve stampë, që paraqisnin zakonisht një vajzë të ulur në stol, me librin e hapur mbi gjunjë dhe me vështrimin tretur diku në horizont. Ai kishte parë disa punë të tilla të vendosura në lulishetet në hyrje të konvikteve dhe gjithnjë kishte ndjerë dhimbje për ato vajza që mbanin mbi supe bronzin e rëndë, të detyruara nga gjithfarë skulptorësh mediokër. Gjithherë në raste të tilla ai provonte një ndjenjë të fortë bashkëfajësie, dhe një Zot e di ç'forcë e mbante për të mos i thyer daltat sapo hynte në studion e tij. Neveria e Alfredit për punë të tilla dihej botërisht, duke u bërë shpeshherë edhe anekdotike në rrethe të ngushta artistësh, ndaj dhe varianti i një porosisje mundshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Konvikteve binte vetvetiu poshtë. Por ndoshta kësaj radhe porosisja mund të ishte më ngacmuese se herët e tjera. Ku i dihej? Ndoshta kësaj radhe zyrtarët e asaj drejtorie të çuditshme kishin vendosur t'i linin atij dorë të lirë në zgjedhjen e temës së punës dhe në realizimin e saj. Ku i dihej? Zyrtarët, në

përpjekjet e tyre të dëshpëruara për të ecur me kohën, jo rrallëherë kalonin edhe para saj, çka i bënte, domosdo, qesharakë e absurdë. Por këtë variant që e ngriti disi rrëmujshëm në kokë, Alfredi e rrëzoi sapo u kujtua për punën e tij të fundit, një nudo të mermertë që kishte skandalizuar bashkëqytetarët e tij, megjithëse në çastet e para të ekspozimit e kishin admiruar. Skulptura e tij e fundit ishte vendosur në njërin prej shesheve kryesorë të Qytetit (mania e zyrtarëve për të ecur me kohën edhe pa e kuptuar atë), duke joshur në fillim shikues të shumtë. Por më pas dikush kishte zbuluar gjurmë mëkati në atë lakuriqësi tronditëse, ndërsa një mësues letërsie që mbahej si njohës e kritik arti kishte dalluar edhe "mungesën e idealit estetik". Kaq kishte mjaftuar që turma t'i shihte me tjetër sy skulpturën dhe skulptorin: të nesërmen e përrurimit, në mëngjes herët, Alfredi kishte vërejtur me dhimbje se nudoja e tij ishte dëmtuar barbarisht në sy, në buzë, në gjoks, në pubis, gjithkund. Ashtu e masakruar, ajo të kujtonte një prostitutë të rrahur e të dhunuar mizorisht pikërisht nga ata që kishin kaluar me të netë të tëra. Me atë veprim barbar, ai Qytet i madh e i lashtë sikur kishte dashur ta pastronte e ta çlironte shpirtin e tij nga mëkatet e panumërta. Megjithëse jo në këto përmasa, Alfredi e kishte parashikuar, me ta filluar punën, se Qyteti do të reagonte ndaj nudos së tij, siç reagojnë në përgjithësi qytetet ndaj gjërave të reja dhe që s'i kuptojnë aty për aty. Për të gjitha këto pra, varianti sipas të cilit Drejtoria e Përgjithshme e Konvikteve mund t'i ofronte realizimin e ndonjë pune, duke u treguar dashamirëse ndaj tij dhe duke i lënë dorë të lirë, binte poshtë. Në një farë kuptimi ai ishte Djali Plangprishës i Qytetit. Mandej, Qyteti kishte me dhjetra skulptorë të tjerë, të aftë për punë si ato që ishin bërë deri më tash e që ishin vendosur anekënd. Atëhere, përse e ftonin të paraqitej urgjentisht? Ç'i duhej asaj drejtorie një skulptor, e për më tepër i papunë? Një Zot e merrte vesh. Sidoqoftë, vendosi të mos e vriste më mendjen e të duronte deri nesër, kur do të sqarohet gjithçka. As miqve s'kishte pse t'u fliste për atë telegram misterioz. As gruas. Deri nesër.

Të nesërmen në mëngjes Alfredi u zgjua i dërrmuar: kishte bërë një gjumë të keq, një gjumë si të arnuar me ëndrra gjithfarësh. Hodhi sytë nga e shoqja që flinte aty pranë dhe, si gjithherë në raste të tilla, u mrekullua nga qetësia e pafajësia që rrezatonte fytyra e saj. Si zakonisht këto kohët e fundit, e pyeti përsëri veten në e meritonte apo jo një grua të tillë, dhe po si zakonisht këto kohët e fundit dha një përgjigje pohuese, sipas një arsytimi që kishte në thelb përfundimin "se ai ishte artist, madje i njohur, dhe si i tillë meritonte edhe më shumë". Mbuloi shpatullën e zhveshur të gruas, e puthi lehtë në qafë dhe u ngrit nga shtrati. Njëherë deshi të rruhej, por pastaj ndërroi mendje, nuk ia vlente. U la me të shpejtë, u vesh dhe doli jashtë. Në rrugë u kujtua se nuk e dinte vendndodhjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Konvikteve. Nxori telegramin, por edhe aty nuk shënohej gjë; dy-tre kalimtarë që pyeti e panë të çmeritur dhe i qeshën pas shpine. Intuitivisht mendoi se një drejtori e tillë mund ta kishte vendin vetëm në Bashkinë e Qytetit. Këmbët e çuan aty, nuk ishte gabuar. I treguan zyrën dhe ai trokiti disa herë, derisa një zë i mbytur, si të vinte nga thellësi shpellash, e ftoi të hynte. Hyri brenda dhe nuk u befasua shumë kur para i doli pikërisht C., njëri prej shokëve të tij të rinisë në hershme. C. ishte shëndoshur tepër, dhe me siguri nuk shkruante më vjersha si dikur. Vetëm fytyra i kishte mbetur po ajo: e lëmuar dhe me gropëza të vockla, që Alfredit i kishte kujtuar gjithmonë sipërfaqen e hënës.

– U befasove? – pyeti C., duke shtrënguar fort dorën e vogël të Alfredit.

Alfredi nuk tha gjë. U ul në njërin prej kolltukëve të zyrës, ndezi cigaren dhe soditi për disa çaste një mizë që

përpëlitej mes palave të perdes së najlontë. Pyetjeve rutinë të C., të zakonshme në kësi rastesh, iu përgjigj thatë me një «po» ose «jo».

– Me siguri, të duket qesharake ekzistenca e një drejtorie të tillë si kjo e imja? – pyeti C.

Alfredi përsëri nuk tha gjë.

– E megjithatë, të merresh sot me konviktet është një *imri i vërtetë, – vazhdoi C. pa u ndjerë i fyer nga heshtja e Alfredit, – Janë një mijë gjëra të vogla e të paparashikuara që të hanë shpirtin.*

– Dhe cilën prej këtyre një mijë gjërave të vogla e të paparashikuara ke lënë për mua? – e pyeti Alfredi, duke shtypur fundin e cigares në tavëll.

C. qeshi me të madhe, u shtriq në kolltukun aty pranë dhe pyeti:

– Me sa di unë, ti je i papunë?

– Po.

– Dhe si i tillë ke nevojë për para, megjithëse ju artistët, për hipokrizi, thoni të kundërtën.

– Po, kam nevojë për para.

– Kam një vend pune të lirë, mendova për ty.

– Cili është ai vend?

– Kujdestar në Konviktin e Femrave.

– Tallesh!

– Unë nuk tallem. Unë dua të ndihmoj një mik dhe kaq.

– E di ti se unë merrem me art?

– Po, e di. E kam parë atë femrën lakuriq.

– Dhe sipas teje, një punë e tillë bën për mua?

– Nuk e di. Unë di që është punë pa punë, si i thonë, sepse do ta bëjnë të tjerët, ti vetëm do të japësh urdhra. Di që do të paguhesh shumë mirë dhe kohë të lirë për ato skulpturat e tua do të kesh boll.

Alfredi ndezi një cigare tjetër. Propozimi i C. që në fillim i ishte dukur krejt absurd, tani kishte filluar ta ngacmonte.

– Prej sa vetash përbëhet personeli i Konviktit? – pyeti Alfredi.

– Njëzet, – u përgjigj C. – Të gjitha janë femra, përveç rojes, një plak që ha e pi në Konvikt.

– Po numri i konviktoreve?

– Vitin e kaluar ishin nëntëqind, sivjet janë një mijë.

– Po unë, me ç'cilësi do të jem aty? Me ato të një sulltani, apo të një eunuku?

Në fillim C. s'reagoi, pastaj kuptoi diçka dhe shpërtheu në një të qeshur të furishme që ia vuri në lëvizje gjithë qenien. Barku i hidhej sa lart-poshtë dhe prej syve i vareshin *kokrra të mëdha loti që, si pushonin për një çast në gropëzat hënore të faqeve, binin mbi tapetin e zyrës. Tëk-tëk.*

– Je fantastik, miku im, – gulçonte duke qeshur C. – Je i madh.

Alfredi u ngrit në këmbë: në zyrë bënte shumë vapë dhe atij po i merrej fryma.

– Atëhere, si vendose? – pyeti C. duke fshirë djersët nga qafa e trashë.

– Do të mendohem, – u përgjigj thatë Alfredi.

– Brenda kësaj jave duhet të vendosësh, – tha C. – Konvikti duhet të bëhet gati. Në tetor fillojnë mësimet.

– Nesër të kthej përgjigje, – tha Alfredi dhe doli nga zyra.

3

– Hë? – pyeti gruaja pa arritur të lexonte gjë në fytyrën krejt pa shprehje të të shoqit.

– Më kanë gjetur një vend pune, – tha Alfredi dhe u lëshua në njërin prej kolltukëve të kuzhinës. Ndezi një cigare dhe filloi të vëzhgojë me kërshëri rrathët e kaltër të tymit. Po i ndodhte që, gjithnjë e më shpesh, të habitej pas formave të çuditshme që merrnin rrathët e kaltër, duke harruar kështu shijen dhe efektin qetësues të cigares. Mandej shikoi me bisht të syrit fytyrën si prej fëmije të së shoqes dhe për të kushedisatën herë ia bëri vetes pyetjen e zakonshme të këtyre kohëve të fundit: nëse e meritonte apo jo një grua të tillë. Si dha një përgjigje pohuese (si zakonisht këto kohët e fundit), u shtriq në kolltuk, duke ndjerë një mpirje të menjëherëshme të gjymtyrëve.

– Për ç'punë është fjala? – e pyeti gruaja.

– Kujdestar. Kujdestar konvikti.

– Ti kujdestar konvikti!?

– Po. Konvikt femrash.

Gruaja vuri dorën para gojës si të desh t'i zinte pritë ndo një fjale të papërshtatshme për momentin, dhe më pas shpërtheu në gaz. Qeshte lirshëm dhe me zhurmë, ashtu siç nuk kishte qeshur kurrë në jetën e vet i shoqi.

Alfredi, si përherë në të tilla raste, u ndie keq, në kujtesë i parakaluan vetëtimthi të gjitha tradhtitë (të voglat e të mëdhatë) dhe, si gjithmonë në të tilla raste, u betua para vetes të mos i përsëriste më ato: ajo grua që qeshte mreku-llisht bukur nuk e meritonte.

– Pranove? – Fytyra e gruas u bë serioze.

– Ku ta di unë, – u përgjigj mjegullt Alfredi, – më duket punë e çuditshme. Ti si thua?

- Ne kemi nevojë për para, - tha gruaja.
- Pra, ta pranoj?
- Unë them se po.
- Mos harro se është konvikt femrash...
- Aq më mirë, - tha gruaja, duke dalë nga kuzhina. Në dhomën tjetër dëgjohej një e qarë fëmije.

Të nesërmen Alfredi u paraqit përsëri në Drejtorinë e Përgjithshme të Konvikteve. Nënshkroi një kontratë njëvjeçare pune, piu një kafe me mikun e tij C. dhe u largua. Sipas kontratës duhej të fillonte punë që të nesërmen.

Në ora tetë të mëngjesit Alfredi u paraqit në Konviktin e Femrave, godina e të cilit ndodhej krejt ngjitur me të vetmin universitet që kishte Qyteti. Ishte një ndërtesë e vjetër, që të kujtonte më shumë një kazermë ushtarësh sesa një godinë konvikti. Alfredin e vunë në dijeni për meremetimet dhe zgjerimet e herëpashershme që i ishin bërë asaj, por gjithsesi ai e pati të vështirë ta përfytyronte se si mund të sistemohejshin aty një mijë konviktores. Sidoqoftë, nuk e lodhi gjatë trurin me këso hamendjesh, sepse hesape të tilla nuk i takonin atij, ato duhej të ishin bërë prej kohësh në Drejtorinë e Përgjithshme të Konvikteve. Në orën nëntë, pasi kishte inspektuar të gjitha mjediset e Konviktit dhe kishte marrë shënime të duhura, bëri një takim me personelin. I pamësuar me takime të tilla e, për më tepër, të jepte urdhra, i la të tjerët të flisnin, pa e patur mendjen në ato që thuheshin. Ndër të gjitha fytyrat që ishin aty, vetëm ajo e rojtarit ia vlente të vëzhgohej: katrore, e ashpër, me vija të thella si kanione, ideale për t'u gdhendur në dru.

Mund ta paraqes me vetëm një zgavër të thellë e të zezë në dru mani, tha Alfredi. Kishte dashur të fliste me vete, por siç duket kishte folur me zë, sepse personeli aty reagoi.

– Jam dakord me të gjitha ato që thatë, – foli Alfredi pa i larguar sytë nga fytyra eshtake e rojtarit. – Më 1 tetor Konvikti të jetë gati, kjo është kryesorja. Mund të largoheni. Vetëm rojtari të qëndrojë.

Të gjithë u larguan, mbeti vetëm rojtari, që gjatë gjithë kohës s'kishte folur as edhe një fjalë, duke ngjasuar më shumë me një grumbull kockash lënë rastësisht aty, sesa me një njeri të gjallë. Alfredi e vëzhgoi përsëri me vëmendje: ishte e pamundur ta përcaktoje moshën e atij njeriu. Sytë i

kishin humbur thellë gropave dhe kurrë s'merrej vesh se ku vështronte.

Alfredi nxori paketën e cigareve dhe ia zgjati një. Rojtari nuk e mori, nxori një qese të grisur lëkure dhe drodhi një cigare për vete.

– Si të quajnë? – pyeti Alfredi pa patur ndonjë shpresë të madhe se nga ai grumbull kockash mund të vinte përgjigje.

– Nuk e di, – kërkëllitën kockat me zhurmë, si të kishin zënë ndryshk. – Roje më thërrasin të gjithë.

– Sa vjeç je?

– Nuk e di. Duhet t'i kem kaluar të njëqindat.

– Sa vjet punë ke në Konvikt?

– Gjithë jetën.

– Ke njeri?

– Jo.

– Të del rroga?

– Unë nuk marr rrogë. Ha në Konvikt, fle në Konvikt. Duhanin ma blejnë të tjerët.

– Lodhesh?

– Dikur po. Tani jo. Konviktin e kanë rrethuar me gardh hekuri dhe e ruajnë me policë. Unë ruaj policët. Njerëzit po bëhen të këqinj.

– Ke qenë i kënaqur me punën?

– Konvikti është i çuditshëm. Të riun e bëj fëmijë, ndërsa plakun e vdes.

Alfredi u ndie i pafuqishëm për ta vazhduar bisedën. Ai plak ishte befasues. Para tij ndiheshe si i rastësishëm e kallimtar në këtë botë. Alfredi kishte kohë pa provuar trazime të tilla nga njerëzit. Në gjoks filloi t'i rëndojë ajo peshë e rëndë, mbytëse, prej së cilës do të mund të çlirohej vetëm në studion e tij, kur të ndjente nëpër duar ftohtësinë e metalit të daltave dhe të çekiçit. Instinktivisht ndezi një cigare tjetër dhe e thithi me aq afsh, sa e zuri kolla. Papritur u kujtua për dhomën ku flinte kujdestari dhe tha:

– Dhoma jote është shumë e vogël, mund ta ndërrojmë...

– Më mjafton, – tha rojtari, – edhe varri nuk është më i madh.

Alfredi qeshi pa ditur ç'të thoshte. Ajo peshë e rëndë aty në gjoks ishte bërë e padurueshme. U ngrit në këmbë, i shtrëngoi dorën rojtarit dhe u largua.

Kishte qenë dita e tij e parë e punës si kujdestar konvikti.

Gjithë pasdreken nuk doli nga studioja. Kishte muaj të tërë pa gdhendur. Në fillim punoi shpejt, por më pas u pendua që nuk kishte bërë ndonjë skicim të shpejtë (të paktën në profil) të plakut. Ishte hera e dytë që i trembej reagimit të modelit. Herën e parë i kishte ndodhur me nudon që ishte ekspozuar para pak kohësh në njërin prej shesheve kryesore të Qytetit. Pak a shumë e njëjta gjë po i ndodhte edhe tash me rojtarin e Konviktit. Këto ishin dy raste krejt të veçanta, sepse zakonisht as që e vriste mendjen për reagimin e modeleve e aq më pak të turmës. Ai punonte për vete. Thjesht për vete... Si duket, këtu ndryshonte prej kolegëve të tij. Por në rastin e rojtarit të Konviktit ishte disi ndryshe. Dukej e vështirë për Alfredin, thuajse e pamundur, ta shpërfillte profilin eshtak të rojtarit; njëlloj si të shpërfillje njëqind vjet, njëmijë vjet urtësi e përvojë.

Hodhi daltën përdhe dhe u vu ta sodiste punën e përfunduar. Zgavra në dru (aty ishin të gjitha: edhe goja e rojtarit, edhe sytë, edhe urtësia, edhe përvoja, të gjitha) ishte ngjyer në të kuq alle prej perëndimit dhe dukej si e mbushur me gjak. Duhej ta kisha punuar në gur dhe jo në dru, tha Alfredi me vete, që këtu fillon gabimi im. Më pas përfytyroi reagimin e rojtarit, kur ta merrte vesh se ajo zgavër, as më pak e as më shumë, ishte vetë ai, dhe duart nisën t'i dridheshin, çka i ndodhte sa herë që ishte i pakënaqur me punën e kryer. Mori çekiçin dhe me tërbim goditi bllokun e drunjte, që u çapërgjysmë në një simetri të çuditshme. Në djall ai rojtar me gjithë përvojën e urtësinë e tij, tha Alfredi dhe përsëri goditi me çekiç njërin prej copave të drunjtë, si të desh të shkarkonte aty gjithë zhgënjimin e kësaj pasdrekeje.

Gjatë gjithë shtatorit, në mesin e Konviktit u bënë punë nga më të ndryshmet: u meremetuan dhe u lyen të gjitha dhomat e korridoret (me përjashtim të dhomës së rojtarit), u zëvendësuan pajisjet e vjetra me të reja dhe në oborrin përpara, deri atëhere të thatë e të shtruar veç me zhavorr, u mbollën lule, u vendosën stola të drunjtë, duke u sajuar kësisoj, në fare pak kohë, një lulishte e vërtetë. Kur përgatitjet kishin përfunduar thuajse të gjitha, Alfredi i lindi ideja ta vendoste nudon e tij në lulishten e sapokrijuar para Konviktit. Megjithëse të masakruar, do ta vendoste. Pa i marrë leje askujt. Në fund të fundit, ishte kujdestar Konvikti, d.m.th. i pari aty. Veprroi pa i thënë kujt. Po atë ditë, zonjusha Z., nënkujdestare e Konviktit (diçka si zëvendëse e Alfredit) i kërkoi takim. E priti në zyrë.

– Ajo femër lakuriq duhet të hiqet, madje sa më shpejt, – tha me një frymë zonjusha Z.

Alfredi nuk foli. E ftoi të ulej në njërin prej kolltukëve të lirë, nxori paketën e cigareve dhe ia zgjati.

– Nuk jam nga ato, – tha me rrëmbim zonjusha Z., duke shtyrë me neveri paketën e cigareve.

Alfredi nuk foli. Pa me vërejtje gishtin tregues të dorës së majtë të zonjushës Z., që ishte zverdhur nga nikotina, dhe ndezi një cigare për vete.

– Ajo femër lakuriq duhet të hiqet. Vendosja e saj aty është skandaloze.

Alfredi nuk foli. Shikoi me vëmendje konstruktin tepër të gjatë të zonjushës Z., duke u bindur se trupi i saj – i mrekullueshëm dikur – tani ishte drejt rrënimit të plotë: gjoksi i varej mjerueshëm, vithet i ishin fryrë së tepërmi,

LIBRARI
KALIBROKASTRI
IN 54066

ndërsa për bel as që bëhej fjalë, me gjithë tendosjen e mundimshme të një rripi të trashë lëkure diku nën kërthizë.

– Përse duhet të hiqet nudoja, zonjë?

Pas kësaj pyetjeje, të cilën Alfredi e bëri krejt automatikisht, u përpoq të kujtonte ndonjë prej historive të shumta që qarkullonin rreth zonjushës Z. dhe që atij i kishin rënë dikur në vesh, por e pati thujse të pamundur: ngjarjet e rëndomta dhe që s'i zgjonin interes maksimal, i fshiheshin shpejt nga kujtesa.

– Ju lutem, jo zonjë, zonjushë, – foli me koketëri zonjusha Z., duke hedhur këmbën e djathtë mbi të majtën. Fundi i saj i ngushtë rrëshqiti pafajësisht mbi kofshët e trasha e të nxira nga dielli. Më pas, ajo u përpoq ta shtrinte fundin, por bëri të kundërtën. Alfredi ndjeu një trazim të papritur në stomak, diçka si të përzier, dhe pati dëshirë të ishte vetëm.

– Përse duhet të hiqet nudoja, zonjushë?

Zonjusha Z. u gjend krejt e papërgatitur. Siç duket, kishite pritur një rrjedhë tjetër të bisedës dhe jo përsëritjen e pyetjes. Ndërroi pozicionin e këmbëve, d.m.th. hodhi këmbën e majtë mbi të djathtë, nxori paketën nga çanta e saj, ndezi një cigare (hutimi kishte qenë aq i madh sa kishte harruar refuzimin e pakmëparshëm) dhe u përgjigj po me një pyetje:

– Përse duhet të hiqet?

– Hë pra, përse?

Papritur, Alfredi ndjeu dëshirë të tallej me këtë femër që rrezatonte pa pushim shtirje e hipokrizi.

– Sepse Konvikti ynë gëzon emër të mirë. Ja përse.

Pas kësaj përgjigjeje, që me siguri e vlerësoi si tepër të thukët e të goditur, zonjusha Z. u ndie më e sigurt. U mbështet në shpinoren e kolltukut, pa u merakosur për fundin e ngushtë, që rrëshqiti edhe më. Alfredi u ndie i lodhur, ndezi një cigare tjetër dhe dëshira për t'u tallur me atë femër iu shua në çast. Zonjusha Z., thujse e bindur në epërsinë e saj, sulmoi:

– Unë po pres.

– Çfarë prisni ju, zonjë?

– Jo zonjë, zonjushë.

– Pardon. Çfarë prisni ju zonjushë?

– Që ju të vendosni heqjen e asaj femrës lakuriq nga oborri i Konviktit.

– Përse duhet ta heq nudon nga oborri?

– Si përse? Jua thashë një herë: Konvikti ynë gëzon një emër të mirë, ja përse.

– Ta mbajë dhe ta gëzojë emrin e mirë Konvikti ynë, – Alfredit iu ndez përsëri dëshira që të tallej me këtë femër. – Një nudo e mermertë, e për më tepër e dëmtuar, nuk ia cënon emrin e mirë atij. Ashtu siç nuk e cënon emrin tuaj të mirë fakti që keni këmbë të bukura, megjithëse pak të trasha.

– Unë nuk ju lejoj të talleni!

Zonjusha Z. dukej e çoroditur. U ngrit në këmbë dhe, duke gulçuar, vazhdoi:

– Unë do të protestoj edhe më lart, deri në Drejtorinë e Përgjithshme të Konvikteve. Skulptura duhet të hiqet. Konvikti ynë është institucion tepër serioz dhe delikat, nuk është shtëpi publike. Unë do të protestoj. Po, po, do të protestoj.

– Si të doni, zonjushë, – tha Alfredi thatë. Ndihej i lodhur dhe nuk kishte kurrfarë dëshire ta vazhdonte bisedën.

– Pastaj mos harroni se, përveç të tjerave, skulpturës suaj i mungon edhe ideali estetik, – tha zonjusha Z. duke dalë nga zyra.

Stafani pa me çudi se si tundej e shkundej gjithë ajo masë tulesh që përbënte të ndenjurat e zonjushës Z., dhe u bind se gjatë gjithë vitit atë do ta kishte armiken më të betuar këtu në Konvikt.

Pasdreke e thirri në telefon Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve. Kërkoj të dinte gjithçka rreth nudos dhe incidentit me nënkujdestaren e Konviktit. Në fillim Alfredi u befasua nga informimi kaq i shpejtë i Drejtorit të Përgjithshëm por më pas, ndërsa jepte sqarimet, iu kujtua turbull se shumë vite më parë, kur zonjusha Z. ishte mësuese në një fshat të largët, ishte folur për një flirt mes saj dhe C.

– Sidoqoftë, skulptura le të qëndrojë aty, – zëri i drejtorit vinte i rëndë, thua se fjalët, gjatë artikulimit, merrnin me vete edhe dhjamrat e tepërt. – Le të qëndrojë, nuk më duket se ka ndonjë gjë të keqe. Në fund të fundit, vepër arti është. Më dëgjon? Po të ishte e veshur, më mirë do të kishte qenë, por edhe kështu s'prish ndonjë kushedi çfarë. Më dëgjon? Ndërsa me zonjushën Z. mund të jesh më i kujdesshëm. Është punëtore. E do Konviktin. Mund ta kesh krah të djathtë. Më kupton?

– Po si t'ia bëj që unë jam mëngjërash, – tha Alfredi dhe e mbylli telefonin.

6

Javën e fundit të shtatorit filluan të mbërrinin konvikto-ret e para. “Janë prej visesh të largëta, prandaj vijnë para kohe,” kishte thënë rojtari. Alfredi s’e kishte kuptuar arsye-timin e plakut dhe kishte kërkuar sqarim të mëtejshëm. “Largësia gjithmonë të bën të ngutesh”, kishte thënë rojtari dhe ishte larguar, duke e quajtur bisedën të mbyllur.

Konvikto-ret e para (nuk ishin më shumë se pesëdhjetë) treguan që në fillim interesim për nudon e mermertë vendosur në oborrin para Konviktit; që pas perdeve të najlonta të zyrës së tij, Alfredi shihte se si ato i silleshin rrotull skulpturës, e lëmonin me gishtërinj (nudoja kishte madhësi natyrale) dhe, më pas, uleshin në stolat e drunjte përreth oborrit.

Në drekë, kur Alfredi po bëhej gati të dilte, trokiti dera e zyrës: ishte njëra prej konvikto-reve të para.

– Më falni, mund të hyj?

– Ju lutem! – Alfredi tregoi me dorë njërin prej kolltukëve, pastaj shikoi me vërejtje vajzën. Kishte një fytyrë tepër të pastër e të lëmuar, si prej mermeri. “Edhe puthja e ndot fytyrën tënde,” kujtoi ai një varg poezie të lexuar kushedi-sekur dhe ndezi një cigare.

– Më falni për guximin... – Vajza u skuq dhe humbi në kolltuk.

– Ju lutem, – tha Alfredi përsëri dhe u ndie mirë nga hutimi i vajzës. – Rrini lirshëm. Keni ndonjë problem, ndonjë mungesë?

– Jo, asgjë. Më falni... nëse më lejohet t’ju pyes për skulpturën... E juaja është?

– E keni fjalën për atë para Konviktit?

– Po, për atë.

– E imja është.

– E mrekullueshme!

– Falemnderit.

– Mund t'jua bëj një pyetje?

– Ju lutem...

– Kush e ka dëmtuar ashtu?

– Qyteti, – u përgjigj Alfredi dhe bëri me gisht nga dritarja. Ishte një ditë e nxehtë, plot avuj, dhe Qyteti dukej si pezull. Alfredi ndezi një tjetër cigare dhe pyeti:

– Përse ju pëlqeu aq shumë skulptura?

– Ka shumë dhimbje në të, – tha vajza, – thua se është gdhendur me shpirt e jo me daltë.

Pas këtyre fjalëve, aty në zyrë ra heshtja. Alfredi pa vjedhurazi trupin e vajzës dhe u mrekullua nga harmonia e linjave. Më pas, krejt papritur, pyeti:

– Ju merreni me art?

– Shkruaj pak, – tha vajza dhe u skuq përsëri, – ndonjë poezi në të rrallë.

– Do të kem rastin t'i lexoj?

– Nëse nuk bezdiseni...

– Aspak.

Në zyrë ra përsëri heshtja. Siç ndodh rëndom mes dy njerëzish të cilët kuptohen që në fillim njëri me tjetrin, dhe më pas e kanë të vështirë të sajojnë biseda të tepërta e të shtirura.

– Mund të largohem? – Zëri i vajzës qëndroi pezull për disa çaste, si shpend i hutuar që s'di ta gjejë folenë.

– Si të dëshironi.

Ndërsa konviktorja tërhiqte derën pas vetes, Alfredi u kujtua ta pyeste për emrin.

– Terezë, Terezë D., – u përgjigj ajo dhe iku.

Alfredi u shtriq në kolltuk dhe thithi cigaren me kënaqësi. U pa në pasqyrën përballë dhe vetja i pëlqeu. Kishte kohë pa shijuar vetveten në pasqyrë. Papritur u hap dera e zyrës: ishte nënkujdestarja e Konviktit.

– Si hyni kështu pa trokitur! – tha Alfredi me ton.

– Më falni, kujtova se ishit larguar... si çdo ditë. – Zonjusha Z. dukej e inatosur, dhe një tik nervor ia dridhte lehtë faqen e djathtë.

– Kishit ndonjë problem?

– Unë problem? Asnjë problem... I zgjidh vetë problemet e mia unë... Veçse desha t'jua kujtoj se pritja e konviktove bëhet sipas një orari të caktuar nga Këshilli i Konviktit, dhe jo kur t'jua ketë qejfi juve. Ne jemi institucion serioz, nuk jemi as han e as shtëpi publike...

– Jashtë! Jashtë! – ulëriu Alfredi. Ishte skuqur në fytyrë, dhe i mbështeti fort në të dy krahët e kolltukut duart që i dridheshin.

Zonjusha Z. u step nga shpërthimi i beftë i eprorit të saj, belbëzoi diçka pa kuptim dhe doli jashtë pa thënë asnjë fjalë. Alfredi ndezi një cigare tjetër dhe u mbështet i lodhur në shpinoren e kolltukut. Kalime të tilla të rrufeshme nga një gjendje në një tjetër – si kësaj radhe – gjithnjë e kishin lodhur; nëse ajo vajzë e bukur që shkruante vjersha i kishte krijuar në shpirt një oaz qetësie e vetëbesimi (sado të vockël), ardhja e papritur e zonjushës Z. kishte tharë çdo gjë. Në gojë kishte një shije të njelmët (thua se pas tharjes së atij oazi kishte mbetur veç kripa) dhe cigarja nuk i shijonte më. Krejt pavetëdijsëm e hodhi diku. Pas pak dëgjoi erën karakteristike të leshit të djegur. U soll për disa çaste i hutuar nëpër zyrë, derisa dalloj një fjollë tymi diku në cepin e tapetit. Tapeti i zyrës ishte i kaltër, dhe fjolla e tymit që spërdridhej krejt nazike i kujtoi Alfredit një bimë uji. Më pas, era e leshit të djegur u bë edhe më e rëndë. Alfredi shkeli me këmbë cigaren e ndezur dhe u shkreh në kolltuk: ndihej i lodhur, tepër i lodhur. U kujtua për relacionin që duhej dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Konvikteve, por u ndie krejt i pazoti për ta filluar një punë të tillë. Mund ta bënte nesër, ose edhe pasdreke.

Doli nga zyra dhe, ndërsa kalonte nëpër oborrin para Konviktit, i tërhoqi vëmendjen një perde që lëvizi paksa në njërën prej dritareve të Katit të dytë të godinës. Më pas, aty u shfaq një siluetë që atij iu duk si e konviktores që kishte pritur pak më parë në zyrë. Krejt instinktivisht ngriti dorën dhe përshëndeti.

Gjatë gjithë pasdrekes Alfredi ishte nervoz dhe i papërqendruar. Ndenji gati dy orë në studio pa bërë asgjë, u grind me gruan, e cila gjithherë në raste të tilla dyshonte për ekzistencën e ndonjë femre tjetër, fyu krejt pa shkak njërin prej miqve që i erdhi për vizitë, derisa në darkë, pikërisht në atë orë kur thuajse të gjitha stacionet televizive jepnin lajme, e kërkuan në telefon.

– Fatkeqësisht, është mashkull, – tha gruaja me cinizëm dhe ia la receptorin në dorë.

Alfredi e pa me mospërfillje dhe ia pohoi vetes për të kushedisatën herë se ajo grua s'kishte për ta kuptuar kurrë. Afroi aparatën pranë veshit me një parandjenjë të turbullt se duhej të ishte Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve. Nuk qe gabuar. Si dhe herën e parë, zëri i C. vinte i çuditshëm, i rëndë, gati-gati lëndor, dhe Alfredi s'do të habitej aspak sikur në atë çast ta njoftonin se linja e tij telefonike ishte këputur.

– Përsëri jeni grindur me zonjushën Z.? – pyeti C. nga ana tjetër. Toni dukej i ashpër dhe autoritar, megjithëse artificial.

– O Zot i madh! – tha Alfredi dhe shfryu si ta kishte C. aty pranë. – Përditë rrëfehët te ti ajo femër? Si nuk gjen një kishë tjetër, më të re, më të bukur...

– Nuk po të kuptoj, miku im, – e ndërpreu C. – Ç'hyjnë këtu kishat e xhamitë.

Hutimi e habija e C. ishin të sinqerta dhe Alfredit i erdhi për të qeshur.

– Më fal, bëra shaka, – tha Alfredi thatë dhe me dëshirën për ta mbyllur bisedën sa më shpejt. – Ajo grua sot u soll keq me mua, madje më fyeu.

– Por edhe ju duhet të jeni më autoritar, më të matur, më të kujdesshëm...

– Më falni, për çfarë kujdesi e keni fjalën? – e ndërpreu Alfredi eprorin e tij.

– Po ja, ju më kuptoni... ne kuptohemi... Ne të dy jemi meshkuj... Kemi dobësitë tona, por kjo s'do të thotë të abuzojmë. Ju më kuptoni drejt, besoj? Edhe nëse abuzojmë për një çast, s'na falet të jemi të pakujdesshëm. Jo të gjitha

punët bëhen ditën për diell... përndryshe, pse do të ishte nata? Më kuptoni? Mandej mos harroni, neve na është besuar një institucion tepër delikat... Më kuptoni drejt, besoj?

– Ju kuptova fare mirë, – tha Alfredi dhe mbylli telefonin. Më pas, u soll për disa kohë nëpër shtëpi pa ditur ç'të bënte. Ndihej i lodhur dhe i kishte filluar dhimbja e kokës, çka do të thoshte një natë pa gjumë përpara.

Natës pa gjumë, pikërisht kësaj, i trembej më shumë se çdo gjëje.

Ishte dita e fundit e shtatorit. Të nesërmen fillonin mësimet. Konviktoret kishin ardhur thujtë të gjitha, dhe ato pak që s'ishin paraqitur ende pritej të vinin pasdreke, me trenin e fundit. Gjatë gjithë javës Alfredi kishte ndjekur me vëmendje reagimin e konviktoreve ndaj skulpturës së tij vendosur në oborrin e Konviktit: që pas perdeve të najlonta të zyrës kishte parë se si ato e sodisnin me kureshtje atë lakuriqësi të masakruar (ndoshta kështu bëhej edhe më misterioze?), kishte regjistruar fragmente të rastësishme bisedash që kishin në qendër nudon e mermertë e autorin e saj (d.m.th. vetë atë, Alfredin) dhe për të gjitha këto ishte ndjerë jo pak i përkëdhelur në sedër, çka s'i kishte ndodhur herë tjetër më parë. Nëse për punë të tjera kishte qenë krejt mospërfillës ndaj reagimit të publikut por edhe të kritikës që mbahej si e specializuar, me këtë të fundit (d.m.th. me nudon e mermertë) po i ndodhte krejt ndryshe: jo vetëm që s'ishte aspak mospërfillës por, përkundrazi, tregohej tepër i ndjeshëm ndaj çdo reagimi, sado të vogël e të parëndësishëm në dukje; dhe kjo jo vetëm me kritikën që mbahej si e specializuar, por edhe me turmën që jepte konsiderata e vlerësime nga më të çuditshmet e kontradiktoret. Gjithë këtë shqetësim të tijin për të mbledhur e seleksionuar opinionet e konsideratat rreth punës së fundit, ai e lidhte me faktin se kishte qenë pikërisht kjo skulpturë që ishte keqinterpretuar më shumë nga kritika që mbahej si e specializuar, duke ndikuar, medoemos, edhe në formimin e një opinioni të përgjithshëm rreth saj. Megjithëse Alfredi ishte shprehur njëherë diku se ishte i bindur në vlerat e punës së tij dhe se as që i bëhej vonë për qëndrimin e të tjerëve, e ndjente (këto kohët e

fundit, sidomos) se në atë deklaratë nuk kishte qenë deri në fund i sinqertë.

Këtë po e provonte edhe tash, tek vëzhgonte me vëmendje reagimin e konviktoreve ndaj nudos së tij. Po e përjetonte aq intensivisht këtë situatë, saqë ishte në gjendje t'i njilhte e t'i dallonte konviktoret që ishin pro ose kundër skulpturës së tij. Por sidoqoftë, Alfredi, nisur edhe nga përvoja e tij si artist, nuk ngutej edhe aq të nxirrte përfundime, i bindur se ndjesitë e përshtypjet e para që merrnin konviktoret nga nudoja mund të ishin të sipërfaqshme, madje edhe të rreme, dhe se vetëm me kalimin e kohës, kur mes dy palëve, d.m.th. skulpturës dhe konviktoreve, do të thellohej njohja, pra vetëm atëhere mund të thuhej diçka përfundimtare. Por për një fakt Alfredi ishte i bindur që tashti: ai, si autor i nudos, kishte ngjallur një kërshtëri të jashtëzakonshëm tek konviktoret. Për rritjen e kësaj kërshtërie kishin ndihmuar edhe një sërë historish të çuditshme e gati fantastike që qarkullonin në Qytet dhe që kishin në qendër pikërisht atë, Alfredin (megjithëse më shumë se gjysma e tyre ishin të pavërteta, të sajura). Njëra prej historive të fundit që kishte bërë më shumë bujë dhe që ishte treguar më pas në dhjetra variante të ndryshme nga njëri-tjetri, ishte edhe ajo mes Alfredit dhe modelit që i kishte shërbyer atij për të realizuar nudon e mermertë. Shumë njerëz nga turma, por edhe përfaqësues të kritikës që mbahej si e specializuar, kishin soditur me orë të tëra nudon, duke u përpjekur të gjenin ngjashmëritë mes saj dhe ndonjëres prej vajzave të Qytetit; ishin përmendur emra konkretë e sajuar thashetheme nga më fantastiket, por në përfundim çdo gjë kishte mbetur e mjegullt, thjesht në kuadrin e hipotezave. Kjo edhe sepse vetë Alfredi, dhe sot e kësaj dite, nuk ishte në gjendje t'i sqaronte raportet që kishte patur me modelin: kishin qenë marrëdhënie eterike, krejt pa trajtë, ose që merrnin njëmijë e një trajta, si mjegulla e mëngjesit, aq sa shpesh herë ai vinte në dyshim edhe vetë ekzistencën e modelit.

Në drekë, Alfredi nuk u largua si zakonisht: do të priste edhe trenin e fundit që do të sillte edhe ato pak konviktore që kishin mbetur pa ardhur. Deshi të merrej me relacionin që duhej dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme, kur trokiti dera. Ishte Terezë D., bukuroshja me fytyrë të pastër e të lëmuar. Dukej e hutuar dhe e tronditur, çka do të thoshte siguri dhe vetëbesim për Alfredin.

– Urdhëroni, uluni, – tha Alfredi dhe i zgjati dorën. Dora e vajzës, të cilën ai e shtrëngoi më shumë se ç’duhej, u drodh si shpirt zogu.

– Ju solla poezitë, – tha Terezë D. e skuqur flakë.

Alfredi, që kishte kohë pa parë femër që skuqej, u ndie papritur mirë dhe në formë. Ndezi një cigare dhe u ul pranë vajzës. Prej saj vinte një erë e mirë dhe e lagësht: siç duket, kishte fare pak kohë që kishte dalë nga banja.

– Dushet funksionojnë në rregull? – pyeti befas Alfredi.

Vajza u shtang: me siguri, ishte e vetmja pyetje që nuk kishte parashikuar se mund t’i bëhej. Alfredi qeshi me hutimin e saj. Pas tij qeshi edhe Terezë D. Alfredi u mrekullua nga qeshja e saj e bukur, megjithëse jo aq e natyrshme sa e gruas së tij.

– Ju studioni për letërsi?

– Jo, ekonomi.

– Në ç’vit jeni?

– Në të fundit.

– Ju pëlqen Konvikti?

Terezë D., si të kishte vite e shekuj që e priste këtë pyetje, shpëtheu papritur:

– Aspak! E urrej!

– Pse? – pyeti jo pak i habitur Alfredi.

– Sepse është bashkësi, është kolektiv. Ta shkatërrojnë, të lë pa individualitet.

– Po kjo varet nga ju, nga predispozitat tuaja...

– Nuk është krejt ashtu. Konvikti është dinak, diabolik.

Vepron pa u ndjerë, me durim të çuditshëm, sekondë pas sekonde, orë pas ore, ditë pas dite. Ashtu si lumi që i lëmon e i bën të njëtrajtshëm gurët e tij, ashtu vepron ai me konviktoret.

– Përsëri nuk jam krejt dakord me ju. Mendoj se edhe në kushte konvikti njeriu mund dhe duhet ta ruajë thelbin e tij. Le të lëmohet guaska...

– Ju bëni fjalë për heronj, por ata kanë vdekur prej kohësh. Unë them për njerëzit e gjallë prej mishi e gjaku, për ata që na sillen përditë nëpër këmbë. Ata janë lëmuar, janë bërë të njëtrajtshëm si gurët e lumit. Të njëllajtë në ecje, të njëllajtë në fjalët që thonë, të njëllajtë në mendime, të njëllajtë në dashuri, si robotët. Po, po, si robotët!

Alfredi ndjeu t'i digjinin gishtërinjtë nga cigarja e ndezur: kishte harruar ta fikte. E shtypi në tavllën që kishte përpara dhe ndezi një tjetër. Gjithmonë e kishte çmuar intelektin te femrat, megjithëse e kishte hasur tepër rrallë.

– Ju nuk e dini se ç'kërshtëri ka ngjallur skulptura juaj te konviktoret? – pyeti Terezë D. veten më shumë se Alfredin. – Sepse në të ka shpirt, ka pikërisht atë që i mungon Konviktit tonë. Ndoshta secila prej nesh ëndërron e dëshiron të ishte në vend të asaj skulpture, qoftë edhe për një ditë, qoftë edhe për një çast të vetëm.

– Përse?

– Si përse? Thjesht për t'u çliruar nga ai burg që quhet Konvikt. Qoftë edhe për një ditë, qoftë edhe për një çast.

– Po ky çlirim, në këtë rast, a nuk do të ishte thjesht një iluzion?

– Le të jetë iluzion. Njeriu ka nevojë dhe për to, madje shumë. Ndoshta mungesa e iluzioneve i ka bërë njerëzit kaq të ngjashëm njëri me tjetrin. Ju mund të thoni se edhe skulptura juaj është pjellë e një iluzioni. E ç'rëndësi ka kjo për mua, kur në të ka aq shumë dhimbje, aq shumë shpirt; pikërisht ato që më mungojnë mua dhe shoqeve të mia.

– Ju doni të thoni se Konvikti e vret shpirtin?

– Ndoshta jo, jo vërtet këtë. Por që e zhvlerëson atë, që e bën të njëtrajtshëm e të lëmuar si gur zalli, kjo s'ka dyshim. Dhe, për mendimin tim, shpirti është thelbi i njeriut.

– Pra, sipas jush, nuk mund t'i bëhet ballë trysnisë së Konviktit?

– E vështirë, e pamundur... E kam fjalën për njerëz dhe jo për heronj...

– Po rasti juaj a s’ dëshmon të kundërtën e gjithë atyre që thatë deri tani?

Vajza nuk u përgjigj. E skuqur nga komplimenti që i erdhi krejt papritur, vendosi poezitë mbi tavolinë dhe u ngrit në këmbë.

– Janë poezitë. I shihni nëse keni kohë... Unë po largohem... ndoshta ju bezdisa...

– Aspak, – tha Alfredi me një frymë. – Ishte kënaqësi e veçantë për mua, mund të vini kur të dëshironi.

Terezë D. tha një «falemnderit» të lehtë që mezi u dëgjua dhe doli jashtë. Alfredi u ngrit në këmbë, iu afrua dritares dhe lëvizi paksa perden. Prej aty nudoja e tij dukej në profil. Ndoca dhjetë konviktores, siç duket ato që kishin ardhur me trenin e fundit, e sodisnin nga afër. Alfredi ndjeu papritur një këputje të përgjithshme të gjymtyrëve dhe u mbajt për hekurash të dritares që të mos rrëzohej. Në atë gjendje e gjeti zonjusha Z. që, si zakonisht, hyri pa trokitur.

– Ju jeni zverdhur, nuk jeni mirë! – tha zonjusha Z. me alarm dhe i zgjati dorën.

– Asgjë. Do më kalojë. Ishte një marrje e lehtë mendsh, – tha Alfredi dhe u fundos në kolltukun që kishte më pranë. Kërkoj një gotë ujë dhe, si piu gjysmën e saj, u ndie më mirë.

– Sapo erdhi edhe treni i fundit, – tha zonjusha Z., duke u ulur në njërin prej kolltukëve pranë Alfredit. Kishte veshur një fustan të ri dhe kishte ndërruar krehjen e flokëve.

– Arritën të gjitha konviktores? – pyeti Alfredi.

– Të gjitha.

– Pra, u bënë njëmijë?

– Njëmijë rumbullak, – tha zonjusha Z. dhe qeshi me zë të lartë. Alfredi dalloj në çast një dhëmb të florinjte në të djathtë të gojës së saj dhe ndjeu përsëri një marrje të lehtë mendsh. Kishte alergji për dhëmbët metalikë, sidomos në gojën e femrave. Nuk ia merrte mendja se mund të puthte ndonjëherë gojë me dhëmbë të tillë.

– Ka ndonjë problem? – pyeti Alfredi krejt automatikisht.

– Çdo gjë në rregull, vajzat janë sistemuar të gjitha. Në mbrëmje, në ora tetë, vendoset edhe shërbimi i rregullt policor.

- Sa policë janë?
- Dy për çdo turn.
- Është e domosdoshme prania e tyre?
- Si nuk qenka e domosdoshme... Ç’thoni kështu? Pa policët, Konvikti ynë do të kthehej në han.
- Gjithmonë është ruajtur me policë Konvikti ynë?
- Jo gjithmonë, vetëm këto pesë vitet e fundit.
- Pra, dikur ka bërë edhe pa policë?
- Po, por tani kanë ardhur kohë të tjera. Njerëzit janë bërë të këqinj, vajzat janë tërbuar...
- Mirë, mirë, – e ndërpreu Alfredi, duke lëvizur dorën me bezdi, – mund të largoheni.
- Po unë ende s’kam mbaruar, – tha zonjusha Z. e fyer. Dukej sikur edhe pak e do t’ia plaste vajit. Alfredi e pa i çuditur dhe ndërroi ton:
- Më falni, jam pak i lodhur. Mund të vazhdoni.
- Është bërë traditë në Konviktin tonë, që ditën e parë të shkollës, d.m.th. nesër, drejtori të mbajë një fjalim para konviktoreve...
- Unë fjalim? Para konviktoreve?
- Po. Kështu kanë vepruar të gjithë para jush.
- Dhe ç’duhet të them në atë fjalim?
- Gjëra të përgjithshme thuhën. Kërkohej nga konviktorët rregull, disiplinë, seriozitet. Po të doni, jua përgatis unë fjalimin që sonte, me shkrim. Kam përvojë, ua kam bërë edhe drejtorëve të tjerë para jush...
- Nuk është nevoja, – e ndërpreu Alfredi, duke tundur përsëri dorën me bezdi. – Kishit ndonjë gjë tjetër?
- Kisha edhe diçka, nëse ju nuk zemëroheni dhe nuk ma merrni për të keq...
- Urdhëro, fol!
- Nuk zemëroni?
- Nuk zemërohem. – Alfredi po e humbiste durimin. Shtirja e bënte krejt antipatike zonjushën Z.
- Ajo konviktorja e herës së parë, ka qenë përsëri tek ju?
- Po, – u përgjigj Alfredi.
- Dhe ka ndenjur jo pak në zyrën tuaj?
- Po.

– E dini se kjo mund të lërë shteg për keqkuptime?

– Po.

– Ju po talleni me mua?

– Jo.

Zonjusha Z. pa e çmeritur përreth, pa ditur ç'të thoshte më. U ngrit në këmbë dhe ashtu mbeti për disa minuta.

– Marrëdhëniet mes nesh mund të jenë më të drejta, më të mira, – tha më në fund ajo.

– Nuk kam asnjë kundërshtim, – u përgjigj Alfredi.

Zonjusha Z. kryqëzoi krahët poshtë gjoksit dhe ndenji për pak kohë pa folur, por më pas, si e kuptoi kotësinë e pranisë së saj aty, doli jashtë.

Alfredi mori frymë thellë, si të ishte çliruar papritur nga kushedi ç'peshë e rëndë, dhe ndezi një cigare. U kujtua për fjalën që duhej të mbante nesër para konviktoreve, u ngrit dhe doli nga zyra.



Në darkë, Alfredi ndjeu një dëshirë të beftë për punë dhe u mbyll në studio. Gruaja, si zakonisht në të tilla raste, parashikoi ekzistencën e ndonjë femre tjetër dhe u mbyll në dhomën e gjumit. Sidoqoftë, incidente të tilla ishin bërë tashmë të zakonshme për Alfredin, ndaj edhe ky i fundit nuk e zbehu aspak dëshirën e tij për punë. Për gati tri orë u mor me kompozimin e tre cilindrave metalikë dhe, si u bind se puna e tij ishte thuajse e përkryer, vuri poshtë diçiturën: *Terezë D.* Më pas, u kujtua për fjalimin që duhej të mbante para konviktoreve dhe mendoi të hidhte dy-tri mendime në letër, por, sa filloi, një mundim i tillë iu duk i kotë dhe e la. Gjithmonë e kishin bezdisur fjalimet, sidomos ato në letër. Megjithëse në këtë rast ishte diçka tjetër, bëhej fjalë për një situatë krejt të veçantë: nesër do të kishte përballë jo dhjetë a pesëmbëdhjetë veta, por njëmijë, njëmijë konviktore, njëmijë femra të cilat, pa dyshim, prisnin prej tij diçka krejt ndryshe nga drejtorët paraardhës, një fjalim krejt të veçantë e origjinal. Kjo lidhej, pa diskutim, me skulpturën e bujshme vendosur në oborr, autor i së cilës ishte pikërisht ai, drejtori, kujdestari i Konviktit. Parë në këtë këndvështrim, fjalimi i tij i nesërm para njëmijë konviktoreve ishte dhe njëfarë prezantimi, madje, thënë pa frikë, prezantimi i parë. Sepse gjatë gjithë javës në të cilën kishte vazhduar ardhja e konviktoreve, Alfredi ishte shfaqur pak ose aspak në mjediset e Konviktit, duke u mbyllur në zyrën e tij. Thuajse të gjitha konviktoret nuk e njihnin fizikisht kujdestarin e tyre, për faktin e thjeshtë se ai, gjatë gjithë asaj jave, kishte dalë në Konvikt në mëngjes herët, kur ato ishin në gjumë, dhe ishte larguar në drekë, kur ato pushonin. Vetëm një konviktore, Terezë D., mund të mburrej se e njihnte disi atë.

Në kushte të tilla, ai ishte prezantuar para konviktoreve përmes dy burimeve të tërthorta; së pari, përmes historive që qarkullonin rreth tij dhe që nuk ishin të pakta, megjithëse gjysma të pavërteta e të trilluara; së dyti, përmes nudos së vendosur para Konviktit e që, pa dyshim, kishte ngjallur kërkshëri e kureshtje të pazakontë. Duke qenë të tërthortë, të dy burimet ishin bërë shkak që rreth figurës së Alfredit të hidhej një vel enigme e misteri, çka ai e kishte parandjerë intuitivisht që në fillim, ndaj dhe nuk ishte befasuar edhe aq, kur një fakt të tillë e kishte pohuar edhe konviktorja e bukur Terezë D. Prandaj dhe në rrethana të tilla, kur për të ishte krijuar një përfytyrim i caktuar (ndoshta edhe i idealizuar e disi iluziv), fjalimi i nesërm para njëmijë konviktoreve merrte një rëndësi të veçantë. Me paraqitjen e tij të nesërme, Alfredi mund ta griste në çast atë vel enigme e misteri që ia kishte hedhur përsipër vetes mjeshtërisht. Ose mund ta bënte edhe më enigmatik, edhe më misterioz; kjo varej prej tij, vetëm prej tij.

Nesër duhej të ishte sa më i veçantë, sa më origjinal. Në të gjitha. Që në veshje, në mimikë, në timbrin e zërit, në lëvizjet e duarve, në përqendrimin e shikimit, në fjalën që do të mbante (aty sidomos!). Paraqitja e tij nesër s' duhej t' u kujtonte konviktoreve asgjë nga kujdestarët e mëparshëm. Ai ishte Alfred D., autori i nudos së famshme, që mbante mbi shpinë sa e sa histori të bujshme. Nesër.

Nesër.

Të nesërmen në mëngjes, Alfredi u zgjua nga zilja e telefonit. Tringëllima e saj ishte e mprehtë, dhe ai pati ndjesinë e fërshëllimës së gjarprit diku rrëzë veshit. Me bezdi ngriti receptorin. Ishte zonjusha Z.

– Mbrëmë ka ndodhur një incident i rëndë, – zëri që përtej telit ishte agresiv dhe ndjellakeq.

– Çfarë? – pyeti Alfredi, duke mbuluar shpatullën e zhveshur të së shoqes.

– Një gjahtar ka fjetur mbrëmë në Konvikt, gjithë natën, – zëri matanë kësaj radhe ishte disi ironik.

– Një gjahtar... në Konvikt? Po ç'dreqin kërkon një gjahtar në një konvikt femrash? – Alfredi u ngrit ndenjurr.

– Nuk thashë gjahtar sorrash, po gjahtar konviktoresh, – zëri matanë ishte bërë nervoz.

Alfredi qeshi me zhurme: u kujtua për atë skortë të rinjsh që silleshin rreth mureve të Konviktit dhe që njiheshin me emërtimin *gjahtarë konviktoresh*. Dikur, për fare pak kohë, edhe ai kishte bërë pjesë në një skortë të tillë, atëhere kur ishte pa kapur daltën me dorë.

– Juve ju vjen për të qeshur? Nuk shqetësoheni për këtë fakt tronditës? – zëri matanë përpëlitej si shpend i plagosur.

– Shqetësohem që ç'ke me të, – tha Alfredi patetik, duke vëzhguar me bisht të syrit zgjimin e mundimshëm të së shoqes. Gjithmonë e kishte përjetuar me kureshtje këtë akt, sidomos atëhere kur zgjimi ishte i detyruar, kur realizohej më shpejt se zakonisht, siç po ndodhte edhe tashti: gruaja rrotullohej për disa çaste nëpër shtrat, pastaj kryqëzonte duart para, thua se këpuste vargonjtë e kushedi ç'ëndrre të llahtarshme dhe, në fund, kapakët e syve rrëshqisnin me mundim lart, si të kishin përsipër një peshë të rëndë. Në këto çaste Al-

fredit i kujtohej ajo shprehja e rëndomtë, sipas së cilës bukuria e vërtetë e një femre vlerësohet realisht menjëherë pas zgjimit të saj, dhe ia pohonte vetes se kishte një grua të bukur, që gjithsesi meritonte një sjellje më të mirë nga ana a tij.

– Ç'ka ndodhur? – pyeti gruaja përgjumshëm.

– Asgjë me rëndësi, – u përgjigj Alfredi, – një gjahtar ka fjetur mbrëmë në Konviktt.

Gruaja nuk tha gjë, i ktheu shpinën dhe, pa kaluar as edhe një minutë, filloi të gërhasë. Alfredi qeshi me zhurmë.

– Ju po talleni? – zëri matanë pikonte zhgënjim dhe fyerje.

– Më falni, – tha Alfredi, – nuk e kisha me ju.

– Si nuk e keni me mua? Ne me ju, pardon, ju me mua po flisni...

– Dakord, dreqi e mori, – Alfredi po bëhej nervoz. – Unë me ju po flas, vetëm pak më parë nuk e kisha me ju...

– Pra, nuk keni dëgjuar asgjë nga ato që kam thënë unë?

– Të gjitha zonjushë, madje me vëmendje të madhe.

– Dhe nuk shqetësoheni?

– Shumë, zonjushë.

– Ju jeni i ri në detyrë dhe nuk i kuptoni përmasat e këtij skanda...

– Përpiqem t'i përfytyroj, zonjushë.

– Ju përsëri po talleni?

– Aspak, zonjushë, madje po filloj të shqetësohem aq sa dhe ju...

– Ajo vajzë duhet përjashtuar menjëherë, pa asnjë ceremoni, duhet bërë shembull për të nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë të tjerat. Më kuptoni? Ka kohë që në Konvikttin tonë nuk ka ndodhur një skandal i tillë. Duhet përjashtuar menjëherë, që sot. Më kuptoni?

– Ju kuptoj, zonjushë.

– Unë them se masën e përjashtimit mund t'ia komunikonit gjatë fjalimit që do të mbani sot, është një rast ideal. Madje s'do të kishte asgjë të keqe që i gjithë fjalimi juaj të përqendrohej rreth këtij skandali. Është një rast i bukur për ta filluar mbarë punën, për t'u treguar në lartësinë e detyrës suaj. Me këtë masë, autoriteti juaj do të rritet tepër...

– Është dakord Këshilli i Konviktit që ajo vajzë të përjashtohet?

– Plotësisht. Kam biseduar vetë me të gjithë anëtarët.

– Sikur ka një postë policie në hyrje të Konviktit? – tha Alfredi me gjysmë zëri.

– Ç’keni me policët? Nuk kanë faj ata! I gjithë faji është i vajzave, – zëri matanë tashmë ishte bërë krejt i sigurt.

– Mirë, tani po vij aty, – tha Alfredi plogësht dhe u bë gati ta mbyllte telefonin, kur befas u kujtua dhe pyeti:

– E dini emrin e konviktores?

– Po. Terezë e quajnë. Terezë D.

Alfredi mbylli telefonin dhe u ngrit në këmbë. Gjunjët i dridheshin lehtë.

Zonjusha Z. hyri në zyrë pa trokitur dhe e njoftoi Alfredin se të gjitha konviktoret ishin mbledhur në oborr dhe prisnin daljen e tij. Gjithashtu, ajo tha se fjalimi duhej mbajtur në Ballkon, çka sipas saj do të rriste efektin e fjalëve, nisur edhe nga lartësia mbizotëruese që kishte Ballkoni; zonjusha Z. nuk harroi të shtonte edhe se të gjithë kujdestarët paraardhës aty i kishin mbajtur fjalimet. Më pas ajo deshi të bënte një vërejtje për veshjen e eprorit të saj, që s'iu duk aspak serioze dhe ceremoniale, po nuk guxoi dhe doli jashtë.

Alfredi ndezi një cigare dhe, tek ndiqte me kureshtje rathët e kaltër të tymit, kujtoi me tmerr se nuk kishte asgjë të përcaktuar rreth asaj që do të fliste para njëmijë konviktoreve. Ajo që tash ishte mbizotëruese në trurin e tij mund të quhej thjesht rrëmujë: paragrafë librash të lexuar kushedi se ku e thënie njerëzish të shquar të mbetura në kujtesë, ide e konkluzione të tijat vetjake, rreth botës, njeriut, moralit, përvoja historish e ngjarjesh konkrete, të gjitha këto i harbounin në vetëdije pa kurrfarë rregulli e rendi, si kuaj frekëputur. Dhe në mes të gjithë kësaj katrahure, që të kujtonte tabllotë e Dalisë, shfaqej herë-herë, i rëndë e ulëritës, si dem i ngecur në baltë, skandali i Terezë D.

Alfredi lëvizi paksa perden e najlontë dhe në çast e nuhati tendosjen e turmës që priste aty poshtë. Befas u ndie mirë dhe i kthjellët, fiku cigaren dhe doli nga zyra. Ballkonin e la pas. Kurrë nuk i kishin pëlqyer ballkonet. Gjithmonë i kishite quajtur si përpjekje të mjera të njeriut për t'u shkëputur nga toka, nga fati i tij i paracaktuar. Konviktoreve do t'u fliste te shkallët, krejt para tyre, i barabartë me to. Nëse do të dinte, do të lartësohej menjëherë në sy të tyre. Në të

kundërt, do të rrëzohej përtokë. Ishte në dorën e tij dhe s'varej aspak nga Ballkoni. Në fund të fundit, nuk ishte krejt vetëm, kishte skulpturën që priste atje jashtë.

Doli. Papritur ndjeu një goditje të beftë diku mes ballit dhe këmbët iu morën: njëmijë fytyrat e bukura femërore të ngurosurat në pritje dhe të njëmijë shikimet e fokusuara në një pikë ishin shumë, tepër shumë për një artist si ai. E ndjeu të domosdoshme të mbahej diku që të mos rrëzohej. Turma aty para, thujse instinktivisht e kuptoi nevojën e tij, dhe u hap paksa në mes, aq sa ai ta dallonte skulpturën. Ura u vendos në çast. Ai u ndie krejt mirë dhe u bë gati të fliste. Por befaz ndodhi ajo të cilën ai as që e kishte parashikuar se mund t'i ndodhte ndonjëherë: harroi të fliste; nuk i kujtohe-shin më fjalët që mbështillnin si guacka sendet, nocionet, idetë; nuk i dinte më ligjësitë e lidhjes së shkronjave njëra me tjetrën, e më pas, të fjalëve. Vetëdijen e ndiente krejt të bardhë e të ngrirë, si fushë dimërore, të paaftë për të pjellë diçka. E megjithatë, heshtja e tij aty zgjati fare pak. Ai e ndjeu lëvizjen e buzëve dhe e kuptoi se po fliste. Veçse aspak më me ndihmën e kujtesës a të vetëdijes, aspak. Mekanizma të tjerë, diku brenda tij (ndoshta nënvetëdija, ndoshta shpirti), ishin vënë në lëvizje dhe po e ndihmonin. Ai prej kohësh i kishte quajtur të ndryshkura këto mekanizma, qysh pas përfundimit të nudos së tij, dhe as që kishte shpresuar se ato mund t'i hynin ndonjëherë në punë, sidomos, para një turme, para një kolektivi, siç po i ndodhte sot.

Vetëm kur dëgjoji duatrokitjet dhe ulërimat aty para këmbëve të tij, e kuptoi se fjalimi kishte përfunduar. U bë esëll, duke ndjerë se si vetëdija po e rifitonte tërësisht terrenin e humbur pak më parë, dhe u vu të sodiste konviktoret. Në çast e kuptoi se ajo turmë tash e adhuronte. Ishte një adhurim i veçantë, gati-gati instinktiv, thujse i ngjashëm me adhurimin që ka e hipnotizuara për hipnotizuesin. Po, po, ai e kishte hipnotizuar atë turmë, duke i hedhur përsipër shkulme shpirti e nënvetëdijeje, në një kohë kur përreth ishte e vështirë të ndeshje dhe në atome të tilla. Befaz, krejt papritur, diku në cep të trurit i vetoi një ide: ta pushtonte atë turmë prej njëmijë konviktoresh! Brenda një viti! Duke

filluar sulmin që nesër! I ktheu shpinën dhe hyri në Konvikti. Pas dëgjoi hapa. Ishte zonjusha Z.

– Unë do të ankojem lart! Ju nuk keni folur si kujdestar Konvikti, por si drejtor Çmendine, – tha ajo.

– E saktë, – tha Alfredi dhe u mbyll në zyrë.

Kur doli nga Konvikti, nuk ndjeu kurrfarë dëshire të kthehej në shtëpi. As të takohej me njeri. U end bregut të Liqenit, duke ndjekur me kureshtje ritualin e peshkatarëve që nga vendosja e karremit në grep e deri tek futja e peshkut të zënë në trastë. Ndërsa largohej pa rreth e rrotull dhe, si u sigurua se nuk e dëgjonte njeri, tha me zë të lartë:

– Kështu kam për t'i zënë të njëmijë peshqit e mi të artë, një nga një.

Në shtëpi u kthye në mbrëmje, vonë. Puthi lehtë në faqe gruan dhe qeshi krejt pa shkak.

– Ke pirë? – tha gruaja.

– Jo, – tha Alfredi. – Pse?

– Ku ta di unë. Dukesh si i dehur.

– Nuk kam asgjë, vetëm jam pak i lodhur, – tha Alfredi dhe kërkoi t'ia sillnin darkën në studio.

Në studio ishte rrëmujë. Ai largoi nga kolltuku punën e tij të fundit, kompozimin me tre cilindra, dhe u ul. Ndezi një cigare dhe u shtriq. Ndihej i papeshë, i aftë për të bërë gjëra të jashtëzakonshme. Pastaj u vu të riprodhonte të gjithë skenën e fjalimit në mëngjes para konviktoreve, por nuk kujtonte asgjë, me përjashtim të magjepsjes së turmës në çastin kur ai kishte përfunduar. Shtangien e turmës po, atë e kishte të ngulur në kujtesë deri në detajet më të imta, deri në hollësitë më të panevojshme. Në ato çaste, ajo turmë prej njëmijë konviktoresh i kishte ngjasuar me një trup, me një organizëm të stërmadh që kishte gjetur befaz shpirtin, zemberekun e kurdisjes. Atë zemberek që në pamje të parë dukej i ndryshkur, e kishte kurdisur ai, me fjalët e thëna. Ai ishte bërë shpirti, nordi i asaj turme. Ajo turmë e adhuronte tashmë, kjo s'kishte pikë dyshimi. Dhe mbi këtë adhurim ai do të ndërtonte dhe do ta zbatonte planin e tij. Ani pse, në vështrim të parë, ai plan dukej një çmenduri e vërtetë. Ani pse. Alfredin e kishin lodhur, e kishin velur vogëlsirat me të cilat ishte e mbushur jeta e tij dhe të cilave ishte aq e vështirë t'u shmangeshe, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme që bënte për ta arritur diçka të tillë. Ndërsa pushtimi i asaj turme prej njëmijë konviktoresh ishte diçka tjetër, ishte diçka e mrekullueshme, ndonëse tingëllonte si absurd, si

çmenduri. Por ndoshta pikërisht për këtë ishte diçka e mrekullueshme, për realizimin e së cilës ia vlente të rrezikojë. Një mijë femra të joshura prej tij, një mijë shpirtra, një mijë kështjellëza të pushtuara brenda vetëm një viti! Një çmenduri? Ndoshta për të tjerët, për gjahtarët e konviktoreve, për shembull, që aspironin qoftë edhe një pushtim të vetëm gjatë gjithë vitit. Ndërsa për të, për Alfredin, ishte një mundësi që mund të bëhej realitet me përkushtim, vullnet e këmbëngulje. Sepse ai ndryshonte nga të tjerët, ai gjithmonë i kishte parë nga lart ata. Çka tingëllonte absurde për të tjerët, për Alfredin ishte normale. Kështu edhe në rastin e të një mijë konviktoleve...

– Më mirë fol në telefon sesa me vete, – i tha gruaja që kishte hyrë në studio pa u ndjerë.

Alfredi e pa i çuditur gruan e tij, thua se ajo sapo kishte zbritur nga një planet tjetër.

– Ç' rri si buf? Të kërkon në telefon Drejtori i Përgjithshëm, thotë se është urgjente.

Alfredi u lodh në çast dhe hoqi këmbët zvarrë sikur shkonte në vendin e ekzekutimit. Zbritja në botën reale, në botën e gjërave të zakonshme e banale, kishte qenë krejt e papritur. Telefoni, të cilin e ngriti me përtesë, iu duk si dora e një të vdekuri.

– Fjalimi që keni mbajtur sot para konviktoleve ka qenë skandaloz! – Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve dukej i acaruar.

– Ashtu?! – bëri të çuditurin Alfredi. – Ndërsa mua m'u duk i suksesshëm. Në fund pati duartrokitje.

– Kjo nuk do të thotë se fjalimi ka qenë i suksesshëm. Ndodh që turma të duartrokasë edhe një koncert të dobët.

Alfredi u përtyp. E kuptoi që Drejtori i Përgjithshëm sonte duhej marrë seriozisht. C. mori zemër nga heshtja e vartësit e tij dhe vazhdoi:

– Keni folur gati gjysmë ore dhe asnjë fjalë për rregulloren, disiplinën, detyrat, moralin e Konviktit. Në atë gjysmë ore vetëm budallallëqe keni folur, të denja për një drejtor çmendine dhe jo për një kujdestar të një institucioni serioz siç është Konvikti ynë.

– Ku qëndrojnë këto budallallëqe, zoti drejtor? – Alfredi po e humbiste durimin dhe mezi u mbajt që të mos e mbyllte telefonin.

– Po si ta them... – zëri matanë nuk e kishte më sigurinë e fillimit. – Nuk keni folur asgjë për rregulloren, për fillimin e vitit shkollor. I gjithë fjalimi juaj një jerm ka qenë... Shpirti, shkretëtira e anonimatit, humbja dhe ruajtja e thelbit e ku ta di unë ç'broçkulla të tjera keni nxjerrë nga goja...

– Por ju duhet ta dini se...

– Ju lutem, mos më ndërprisni, – zëri matanë ishte bërë përsëri autoritar dhe i sigurt. – Të paktën për skandalin që ndodhi një natë më parë duhej të flisnit patjetër, duhej bërë shembull ai rast, që të mos përsëritej më. Më kuptoni?

– Ju kuptoj, do ta shqyrtojmë këtë rast, që nesër.

– Dhe të dilni me masë konkrete, ndoshta jo me më ekstremen, siç është përjashtimi.

– Dakord, – tha Alfredi me zë të ulët, duke ia pohuar vetes se, sidoqoftë, miku i tij i rinisë kishte një thelb pozitiv.

– Edhe nga unë mund të vini ndonjëherë, kemi qenë miq dikur. Ndërsa për fjalimin duhet të bindeni se ka qenë një marrëzi që s'duhet përsëritur më. Unë i kuptoj dhe i dua artistët, por një fjalim të tillë si ai i juaji s'kam se si e pranoj. Në fund të fundit, kur ishit kaq i pasigurt, mund ta shkruanit në letër dhe ta lexonit para konviktoreve, siç kanë bërë të gjithë paraardhësit tuaj.

– Ndoshta keni të drejtë, – tha Alfredi i lodhur dhe me dëshirën që ajo bisedë të mbyllej sa më shpejt. – Por edhe ju pak si shumë u besoni agjenteve tuaja. Me siguri, interpretimi që i kanë bërë fjalimit tim ka qenë i gabuar dhe tendencioz.

– Nuk ka kurrfarë tendence. Unë fjalimin tuaj e kam të regjistruar, të gjithin, nga fillimi deri në fund. – Zëri matanë kishte kënaqësinë e pasthirmës së gjahtarit që, pas një pritjeje të gjatë, ka zënë më në fund viktimën në çark.

– Si?! Ju e keni të regjistruar fjalimin tim?! – Alfredi filloi të dridhej nga emocionet.

– Po, të gjithin, nga fillimi deri në fund. Një regjistrim i pastër, i denjë për Pavarotin. – Gjahtari matanë po shijonte

deri në ekstatë përpëlitet e viktimës në çark, duke e shfaqur hapur dëshirën që ta vazhdonte lojën e tij sa më gjatë.

– Nuk talleni? Vërtet e keni të regjistruar fjalimin tim?

– Po. Mund të vini ta dëgjoni.

– Që tani! – tha Alfredi dhe mbylli telefonin pa i lënë kohë atij matanë ta shprehte habinë.

Kishte kaluar mesnata dhe Alfredi rrotullonte nëpër duar atë, kasetën e vogël, pa u besuar syve. E megjithatë ajo ishte aty, peshonte ndër duar: e vockël, e zezë, me dy rrathë në mes si dy sy misteriozë.

Kishte ndodhur diçka e çuditshme, një paradoks i vërtetë: zonjusha Z., me dëshirën për t'i bërë keq, për ta komprometuar përfundimisht, ia kishte incizuar tërë fjalimin, duke i bërë kështu, pa dashjen e saj, një nder, një shërbim të jashtëzakonshëm.

Alfredi kishte qenë i bindur se fjalimi i tij i mëngjesit, ajo dalldisje si në jerm, ai shkrim gati instinktiv i pavetëdijes, kishte humbur, ishte zhdukur, ose – kësaj mundësie ai ishte më i prirur t'i besonte – ishte regjistruar në kujtesën e konviktoreve (a nuk është çdo kujtesë njerëzore një si shirit magnetofoni?) por që, gjithsesi, me gjithë unitetin e kolektivitetin që presupozonte Konvikti (ky unitet s'mund të banalizohet deri në njëllojshmërinë e të njëmijë kujtesave), as që duhej pritur një regjistrim besnik; madje më e saktë do të ishte të shpresoje për njëmijë variante të regjistruara të atij fjalimi mëngjesor, çka lidhet me atë që thamë pak më sipër, pra me faktin e thjeshtë se, edhe në kushtet e një konvikti, intensiteti dhe interesat e kujtesave nuk ka se si të jenë të njëjta, por nëse për një çast supozohej e kundërta (mundësi të cilën Alfredi e kishte çuar disa herë nëpër mend gjatë ditës) d.m.th. që Konvikti me të gjithë mekanizmat e tij kishte imponuar një kujtesë të vetme, një kujtesë të përgjithshme, një makrokujtesë ku ishin të shkrira të njëmijë kujtesat e vockla, atëhere po: duhej besuar e shpresuar në mrekullinë: në një regjistrim besnik të fjalimit; por edhe nëse kjo kishte ndodhur, pra që fjalimi të ishte regjistruar besnikërisht në

makrokujtesën e supozuar, riprodhimi i tij, dëgjimi i tij ishin krejt të paralizueshëm, sepse do të ishte çmenduri e vërtetë të vije si në kor të njëmijë kujtesat – që përbënin makrokujtesën e Konviktit – për ta riprodhuar atë fjalim; mbetej pra mundësia e parë: ajo e regjistrimit të fjalimit në njëmijë variante, mundësi të cilën Alfredi për një çast e kishte vënë në dyshim duke arsyetuar se në kohën kur ishte mbajtur fjalimi i tij turma prej njëmijë konviktoresh kishte qenë e hipnotizuar, e pavetëdijshme (si dhe ai vetë) dhe se në kushte të tilla, kur veç pavetëdijet kishin hyrë në rezonancë, kujtesat (makrokujtesa ose kujtesat e vockla) as që kishin funksionuar, çka do të thoshte se fjalimi nuk ishte regjistruar, ose ishte regjistruar fare turbullt, siç ndodh për shembull me ëndrrat.

Sidoqoftë, Alfredi nuk e lodhi më veten me zhbirilime të tilla. Në duar kishte kasetën, kishte pavetëdijen e tij. Kjo ishte fantastike, e mrekullueshme. Futi kasetën në barkun e magnetofonit dhe shtypi butonin. Ishte ora dy pas mesnate.

Gruaja, aty pranë, flinte.

Edhe bota, matanë, flinte.

Dy sytë e mëdhenj në barkun e magnetofonit u turbulluan, mandej u dëgjua një gërvimë e lehtë dhe, më pas, një zë i çuditshëm, gërryes, i largët, si të vinte prej thellësish qiellore. Alfredi njohu zërin e vet:

"Shpirtra që vuani! Unë jam i bindur se ju vuani, qoftë edhe për faktin e thjeshtë se vuan shpirti im. Por ju vuani dyfish, sepse jetoni në Konvikt, thithni ajrin e Konviktit, merrni frymën e tij. Jam i bindur se ju e urreni Konviktin me të gjitha rregullat e ligjet e tij, sepse edhe unë, dikur, e kam urreyer, derisa ia mësova të gjitha vidat, të gjitha hilet. Dhe nxora një mësim, të cilin jua këshilloj edhe juve: mohojeni Konviktin, mos e përfillni atë, kështu dhe vetëm kështu nuk ktheheni në vida, në burma, në simbole të tij. Unë e kuptoj mirë se nuk është aspak e lehtë të mohohet Konvikti duke qenë anëtar i tij, duke qenë konviktor, përkundraz, është tmerrësisht e vështirë, e mundimshme, sepse Konvikti është si kënetat: të josh me ekzotikën, me misteret e saj, e mandej të përbalt, të thith të tërin, derisa edhe ti bëhesh pjesë e asaj kënete: mëson të fërsëllesh si gjarpërinjtë, të guasësh si bretkosat, të dihatësh si kallamishtet e fëlliqura. Deri para se të vija këtu unë dyshoja në ekzistencën e shpirtit, gati-gati po bindesha se shpirti kishte vdekur ose jetonte si relike muzeu diku në ndonjë trup të vetmuar. Sepse e njoh mirë Konviktin, forcën e tij diabolike. Çdo Konvikt ka një shpirt të vetin që e përpunon, e ndryshon nëpër kohëra, një shpirt gjigand që bluan si mokër shpirtrat tuaj prej fryme. Pikërisht me këtë miell, me miellin e shpirtrave tuaj, gatuhet Shpirti i Madh i Konviktit. Bluarja e shpirtrave tuaj vazhdon gjatë, shumë gjatë, dhe ju mos më thoni se nuk e keni ndjerë ulërimën e tyre nën peshën e rëndë të gurëve të mokrës që sillet e sillet

përjetësisht. Edhe unë, sidomos netëve me hënë, e kam ndjerë ulërimën e tmerrshme të shpirtave tuaj, shpeshherë edhe jam stërpikur me gjakun e tyre, duke parë se si mbeteshin ca njolla në shpirtin tim, ca njolla që s'do të shlyheshin kurrë. Unë jam gëzuar si fëmijë, gëzimi im ka qenë më i madh se i Kolombit kur zbuloi Amerikën, sa herë që jam ndeshur, sa herë që kam zbuluar ndonjë shpirt që i kishte shpëtuar mokrës së Konviktit. Sepse ndodh që ndonjë shpirt t'i shpëtojë bluarjes, miellëzimit (o Zot, sa e mundimshme është një gjë e tillë!) dhe të mbijetojë, ani pse i sakatuar e i gjakosur. Por gurët e mokrës së Konviktit po bëhen gjithnjë e më të rëndë, dhe mundësia e shpëtimit të shpirtave pa u bluar – gjithnjë e më të rrallë, çka do të thotë se sot më e lehtë është të zbulosh një kontinent të ri, sesa një shpirt të pacënuar. Kështu kujtoja unë, kështu mendoja deri para se të vija këtu, sepse i drubesha tepër diabolizmit të përbindëshit. Konvikti është si shkretëtira. Rërë dhe vetëm rërë, kokërriza të vockla të gdhendura me durim nga era e mijëvjeçarëve, që ulërijnë në anonimatën e tyre të verdhë e shterp. Duna dhe vetëm duna, të njëtrajtshme deri në idiotësi. Tek-tuk, në të rrallë (o Zot, sa rrallë!) ndonjë oaz. Kjo është shkretëtira. Ky është Konvikti. Kështu kujtoja unë edhe për Konviktin tonë. Por ndoshta jam gabuar. Unë kam vënë skulpturën time, shpirtin tim lakuriq aty para jush. Dhe ju e keni kuptuar atë, e keni ndjerë atë, çka do të thotë se Konvikti ende nuk ka fituar përfundimisht mbi ju, se mokra e tij ende nuk ka bluar çdo gjë tuajën. Ose, më sak, ka bluar çdo gjë, por ende jo thelbin e shpirtit. Sepse çdo gjë në këtë botë e ka një thelb. Edhe shpirti e ka thelbin e vet. Atë ruajeni. Duke e mohuar Konviktin. Duke mos e përfilluar atë. Le t'ju thonë se bota tash mijëra e mijëra vjet jeton mbi bazën e Konvikteve. Mos u besoni! Le t'ju kërcënojnë me pranga, gryqe, apokalipse. Mos u frikësoni! Jetën e keni të shkurtër (o Zot, sa të shkurtër e keni!), është krim t'ia falësh Konviktit qoftë edhe një sekondë të sajën. Mohojeni Konviktin, ani pse quheni konvikto. Si mund ta mohoni? Ku ta di unë... Secila prej jush le t'i zgjedhë e t'i përpunojë vetë armët. Për shembull dashuria është një armë. Për shembull arti është një armë. Për shembull krenaria është një armë. Mund të më

thoni se këto armë tani janë të ndryshkura, se i ngjasojnë pajimeve të Don Kishotit. Ndoshta keni të drejtë, ndoshta jo. Po a nuk është e gjithë odiseja e Don Kishotit një përpjekje tragjike për t'u shkëputur nga prangat e Konviktit? Unë kështu mendoj, përderisa ende nuk janë zbuluar armë më efikase sesa ato që përmenda pak më sipër. Më mirë le të jemi nga pak Don Kishotë, sesa grimca rëre në anonimatën e shkrëtëtirtë të Konviktit. Bëhuni më mirë viktime të iluzioneve tuaja sesa të gjahtarëve që presin atje jashtë. Mohojeni Konviktin që të mos bëheni skllave të tij. Unë jam me ju."

Kaq ishte fjalimi. Mandej, për pak çaste, një heshtje si prej varri, dhe më pas një stuhi ulërimash: ishte turma që, në ekstazë, miratonte dhe duartrokiste.

Alfredi e vuri përsëri kasetën dhe e dëgjoji edhe një herë tjetër krejt fjalimin. Mandej edhe një herë tjetër. Edhe një herë... Derisa iu duk se e kishte mësuar përmendësh, të tërin. Ndezi një cigare që i shijoi së tepërmi dhe u shtriq në kolltuk. Kishte qenë një fjalim i mrekullueshëm: disi eterik, i patrajtë, një shpërthim i beftë i pavetëdijes. E vuri përsëri kasetën dhe, ndërsa ndiqte lëvizjen monotone të shiritit, u bind se në atë fjalim ishte vetë thelbi i tij si artist dhe si njeri. *Tha me vete se thelbi i çdo njeriu ruhet në pavetëdije, i pëlqeu ky mendim dhe e shënoi diku, pa e vrarë fort mendjen se një përfundim të tillë (apo diçka tjetër të përafërt) mund ta kishin nxjerrë edhe të tjerë para tij. E vazhdoi arsyetimin, duke shtuar se vetëdija ishte guaska që lëmohet, ndryshon, përpunohet, përshtatet e, pse jo, edhe thyhet në vartësi të kushteve e rrethanave në të cilat ndodhet njeriu. Një guaskë e fortë e ruan thelbin. Në të kundërtën...

U ngrit në këmbë dhe filloi të sillej nëpër studio. Ndihej mirë, tepër mirë, i mbushur me vetvete, madje herë-herë kishte përshtypjen se vetvetja po i derdhej nga sytë, si lëngu nga një enë e mbushur plot e përplot. Ai kishte një thelb të pacënuar! Kjo ishte e mrekullueshme. Fantastike. Sepse deri para pak orësh s'kishte besuar në asgjë, as në veten e tij. Sepse deri para pak orësh e kishte kujtuar të prishur, të kalbur, thelbin e tij. Por kishte mjaftuar ajo kasetë e vockël, e zezë, që në honet e shpirtit të tij të ndodhnin ndryshime e zhvendosje gati-gati të pabesueshme. Ai e kishte ruajtur thelbin! Po, po, e kishte ruajtur të paprishur. E dëshmonte ajo kasetë e vockël dhe e zezë që ndrynte brenda pavetëdijen e tij...

...Dhe të mendosh se deri para pak orësh ai e kishte quajtur veten të mposhtur nga trysnia e Konviktit, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për t'iu shmangur kësaj trysnie, përpjekje që bëheshin gjithnjë e më të dobëta, përpjekje që dukeshin gjithnjë e më të kota. Dëshmi e kësaj lodhjeje kishte qenë edhe arti i tij i kohëve të fundit: gjithnjë e më i mjegullt, gjithnjë e më abstrakt, rrjedhojë e drejtpërdrejtë e atyre mosmarrëveshjeve e grindjeve të vazhdueshme mes guaskës e thelbit, mes vetëdijes dhe pavetëdijes. Derisa kishte ardhur një çast kur ai e kishte quajtur të kalbur Unin e tij. Por jo, nuk ishte ashtu, ai kishte mbijetuar. Para njëmijë konviktoreve ai ishte paraqitur me thelbin e tij, me Unin e tij dhe kishte pasur sukses të bujshëm. Pikërisht mbi bazën e këtij prezantimi ai do të ndërtonte dhe do të zbatonte planin e tij, atë të pushtimit të njëmijë shpitrave femërorë. Themelet tashmë ishin hedhur: të thella, të forta, origjinale, ani pse disi të vagullt – si çdo prodhim i pavetëdijes. Tani duhej të ngrinte muret. Kishte një vit kohë. Jo pak, po të mendoje se për themelet i ishin dashur vetëm tridhjetë minuta. Por këtu dilte një problem (Alfredi u ul përsëri në kolltuk dhe ndezi një cigare tjetër): nëse themelet i kishte hedhur pavetëdija e tij, me muret ndryshonte puna, ato duhej t'i ndërtonte vetëdija; ishte krejt absurde të kërkoje angazhimin e pavetëdijes gjatë gjithë vitit, deri në përfundimin e godinës, deri në realizimin e ëndrrës së tij për pushtimin e të njëmijë kështjellave femërore. Atëhere, si do të zgjidhej kjo kontradiktë? Alfredi deshi ta vazhdonte edhe më arsyetimin e tij të ngatërruar, por sytë iu mbyllën dhe fjeti.

Cigarja, si shpirt i trazuar, i digjej në buzë.

Gjatë gjithë javës, Alfredi u soll mjediseve të Konviktit si të ecte nëpër mjegulla. Ndihej mirë dhe në paqe të plotë me veten. Fliste pak me të tjerët, fare pak, duke u përpjekur ta ruante atë imazh që ia kishte krijuar vetes me Fjalimin e Mëngjesit. Rrallë, fare rrallë, i afrohej nudos së tij vendosur aty në mes të oborrit, si për t'i dëshmuar turmës së konviktoleve se ajo skulpturë, që kishte tërhequr në maksimum vëmendjen e tyre, për të ishte diçka fare e rëndomtë, një shfaqje e zakonshme e shpirtit të tij, e thelbit të tij. Herë-herë i sillej nëpër mend Fjalimi i Mëngjesit dhe, gjithherë në raste të tilla, dëgjonte ulërimat e thelbit të tij të fyer prej mantelit hipokrit që ai (Alfredi) i kishte hedhur përsipër, por kjo zgjaste fare pak, sepse ai (Alfredi) kujtohej për detyrën që ia kishte vënë vetes dhe që, kurrsesi, s'mund të realizohej edhe pa ndihmën e vetëdijes.

Ecejaket nëpër korridoret dhe oborrin e Konviktit po ktheheshin në festa të vërteta për të. Gjithnjë ndodhej i rrethuar prej dhjetra e dhjetra konviktoresh. Ai ishte i admiruar prej të gjithave: e ndjente, e prekte adhurimin e tyre. Me qindra autografë lëshoi gjatë këtyre ditëve: ai po kthehej në mit, në perëndi, dhe për një perëndi nuk ka asgjë të pamundur. Ai fliste pak dhe, gjithherë kur i dukej se ishte e domosdoshme të thoshte diçka, thërriste në ndihmë atë, Fjalimin e Mëngjesit, pavetëdijen, duke qenë i bindur se, më pas, fjalët e tij do të komentoheshin gjatë nga konviktoret.

Ai ishte i dashuruar prej të gjithave, kjo s'kishte pikë dyshimi. Sepse ai ishte ajo që i kishte munguar ndër shekuj këtij Konvikti. Alfredi thuajse e dëgjonte ulërimën e të njëmijë shpirttrave femërorë që e joshnin dhe e ftonin. Ishte një

fresë kolektive, e papërballueshme, të cilën ai e kishte ëndërruar për kushedi sa netë me radhë.

Ai, tashmë, e ndjente se nuk i përkiste vetvetes, ose i përkiste fare pak. Ai ishte bërë idhulli i asaj turme prej një-mijë konviktoresh, turmë e gatshme të dorëzohej e të binte në gjunjë, aty para këmbëve të tij. Veçse duhej të vazhdonte të ishte ai që s'ishte. Kjo qe tepër e rëndësishme, vendimtare. Le t'i përkiste fare pak vetes, derisa të realizonte ëndrrën e pushtimit. Duhej ruajtur me të gjitha mënyrat e mjetet ai imazh (i rremë dhe i gënjeshtërt si të gjitha imazhet) që i kishte krijuar vetes para konviktoeve; imazh i lindur mbi bazën e të gjitha atyre historive (shumica trillime) që qarkullonin rreth tij, i përforcuar më pas me nudon e mrekuullueshme vendosur në oborrin e Konviktit, derisa kishte marrë trajtë të plotë (aq sa mund të ketë trajtë të plotë një imazh) me Fjalimin e Mëngjesit, kur në ndihmë i kishte ardhur pavetëdija.

Ai do ta bënte realitet ëndrrën tij të pushtimit, për këtë ishte i bindur tashmë. Turma ishte e nderë nga pritja, madje herë-herë dukej edhe e lodhur. Por Alfredi s'kishte pse të ngutej. Le të priste turma, le të lodhej ajo. Më mirë për Alfredin. Fitoren e kishte fare pranë dhe mjaftonte të zgjaste paksa dorën. Por, sidoqoftë, në gjashtë ditë ai s'bëri asgjë (Perëndia, dikur, në po aq ditë kishte ngjizur Botën), veçse u soll nëpër Konvikt si i dehur, duke u përkundur në tërë atë det adhurimi.

Në njërën prej këtyre gjashtë ditëve pa diku në cep të oborrit të Konviktit Terezë D. Iu duk se në shikimin e saj, në ndryshim nga shikimet e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë konviktoeve të tjera, kishte ironi, dyshim, madje herë-herë edhe nuanca të lehta urrejtjeje. Sidoqoftë, këtë fakt e harroi brenda pak çastesh dhe as që u kujtua më për të. Ndërsa ditën e fundit të javës, d.m.th. të shtunën, pati një inspektim nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili u befasua jo pak nga rregulli dhe harmonia që mbretëronte në Konvikt. Gjatë gjithë kësaj jave nuk ishte regjistruar asnjë incident (viteve të tjera, gjithmonë në javën e parë, gjahtarët krijonin shqetësime duke ngacmuar, sidomos, konviktoret që vinin për herë të

parë në Konvikt dhe që ishin nga zona të largëta); rregulloret dhe oraret zbatoheshin përpikmërisht, madje në ndryshim të dukshëm nga vitet e tjera vihej re një prirje e konviktove për të mos dalë, ose për të dalë fare pak nga mjediset e Konviktit jashtë në Qytet. Këtë përmirësim të jashtëzakonshëm të gjendjes në Konvikt e pohoi edhe zonjusha Z., por duke mos qenë e aftë të shpjegonte arsyet. Gjithashtu, edhe një relacion i ardhur nga Rektorati i Universitetit bënte fjalë "për përmirësime të ndjeshme të disiplinës së studentëve, sidomos atyre femra, dhe për një ngritje të dukshme të interesit ndaj procesit mësimor".

Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve, që kishte pritur të kundërtën, u largua jo pak i çuditur dhe i hutuar.

Ishte e diel dhe Alfredi vendosi të mbyllej në studio gjithë paradreken. Gjatë javës së kaluar s'kishte gdhendur asgjë, duke ngjallur kështu dyshime të reja te gruaja për mundësinë e ekzistencës së ndonjë femre në mes.

Sot kishte vendosur të punonte. Mbrëmë (ashtu si në të gjitha netët e kësaj jave) kishte bërë një gjumë të mirë dhe tani ndihej në harmoni të shkëlqyer me vetveten. Mori njërën prej daltave dhe mandej çekiçin, që iu duk pendë i lehtë. O Zot i madh, sot mund të bëj mrekullira! – i tha vetes dhe kërkoi nëpër xhepa paketën e cigareve. E ndezi një dhe u fundos në kolltukun diku në cep të studios. Sipër çekiçit e daltave, si dhe mbi punët që ndodheshin aty, kishte rënë një shtresë pluhuri. Alfredit iu kujtua në çast thënia e një pedagogu gjatë viteve të shkollës, sipas të cilit, për një skulptor të vërtetë ishte e domosdoshme që herë-herë daltat dhe çekiçi të zinin pluhur; qeshi dhe u ngrit nga vendi. Iu afrua punës së fundit, pikërisht asaj që i kushtohej konviktores së bukur me emrin Terezë D. Edhe mbi të kishte pluhur, aq sa emri nuk lexohej. Me majën e gishtit shkroi mbi pluhur shifrën 1000. Përsëri qeshi.

Ndihej mrekullisht mirë sot. Si asnjëherë: në paqe të plotë me gjithçka, i mbushur deri në fyt me ca ndjesi të ëmbla e fluturake që e bënin gati të papeshë. Në gjoks i rëndonte një dëshirë e unshme për të qenë në mes të njëmijë konviktoleve të tij apo dhe mes njerëzve të tjerë çfarëdo, veç vetëm jo. Deshi të dilte nga studioja, por u kujtua se kishte plot një javë pa gdhendur dhe se sot kishte vendosur të punonte. Le të tregohej pak më i vullnetshëm, dreqi e mori. Le ta mbyste sadopak vetveten për hir të artit. Sot kishte vendosur të punonte, dhe do të punonte edhe sikur të njëmijë

konviktoret ta joshnin e ta ftonin aty pas dritares. Sot do të tregohej Odise. Veshët do t'i zinte me argjilën e kuqe, ndër-sa ato ndjesitë e ëmbla e fluturake, që pak më parë e kishin mbushur të tërin, do t'i ndrynte thellë, sa më thellë. Sot do t'i përkushtohet artit.

Iu afrova njërit prej dollapeve ku mbante blloqet prej dru mani, të prera e të latuara: prisnin vetëm daltën e tij që të ndryshonin trajtë dhe të shprehnin e dëshmonin diçka. Një-rin prej tyre e vendosi në kavalet, por sa mori daltën në dorë u kujtua se nuk kishte kurrfarë ideje për atë që do të reali-zonte sot. Gjithmonë ai kishte hyrë në studio duke patur një apo më shumë ide në kokë, ide që i mbante dhe i përpunon-te gjatë, ndoshta edhe me muaj të tërë. Ndërsa sot ndodhej krejt i papërgatitur, thjesht i kishte vënë vetes qëllim të pu-nonte dhe kaq. Kishte shpresuar se do të punonte, duke i besuar asaj gjendjeje të ngritur shpirtërore në mëngjes, por mjaftoi ftohtësia e metalit të daltës e çekiçit që të ndihej krejt bosh.

Bosh? Kur gjoksin sa s'ia shkallmonte ëndrra e harbuar e Pushtimit të Madh? E megjithatë, e ndjeu në çast se sot s'ki-shte për të gdhendur asgjë.

Ishte tepër i lumtur për të bërë art.

I shtrirë në shpinë, Alfredi pa me bisht të syrit profilin e hequr të së shoqes, mandej hënën aty pas dritares, krejt afër, thua se dhe pak e do të hynte në dhomën e gjumit. Ora e madhe e murit ra dymbëdhjetë herë dhe ai u kujtua se kishite më shumë se një orë i shtrirë aty në krevatin bashkëshortor. Vështirë të flinte më: kishte filluar dita e re, ditë në të cilën do të niste Sulmin e Madh. Nuk kishte frikë – emocione po. Ndoshta do të ishte mirë të flinte sadopak, që në mëngjes të ndihej sa më i freskët, por kjo gjithsesi s'varej prej tij. Në gjoks kishte një shtrëngim të çuditshëm, të paprovuar herë tjetër, dhe para syve i kalonin vazhdimisht, njëra pas tjetrës, të njëmijë fytyrat e konviktoreve. Herëherë, si të mbante në dorë një pult të padukshëm komandimi, fiksonte para syve të tij ndonjërin prej të njëmijë fytyrave, ato më të bukurat, më shprehëset, që i kishin bërë më shumë përshtypje. Mandej e hidhte pultin nga dora dhe fytyrat parakalonin me shpejtësi para tij, duke u përzier e duke u shkrirë njëra me tjetrën, derisa sendërtohej një fytyrë e vetme, e stërmadhe. Pastaj ai përsëri merrte pultin e shkelte butonin, dhe fytyrat përsëri parakalonin me rregull para tij, njëra pas tjetrës. Sidoqoftë, një farë rendi duhej të vinte, njërin prej të njëmijë fytyrave duhej ta fiksonte më gjatë, pikërisht atë fytyrë me të cilën do të niste Sulmi i Madh. Sepse, si çdo sulm, edhe i tiji duhej të kishte një fillim. Me këtë ide në kokë, pra me atë se çdo gjë do të ishte më e lehtë dhe më e thjeshtë nëse Sulmi i Madh programohej e planifikohej disi, Alfredi u ngrit nga shtrati dhe u mbyll në studio.

Në studio kishte listat e sakta të njëmijë konviktoreve. U ul në kolltukun e tij dhe afroi pranë vetes tryezën e punës,

ca fletë të bardha dhe një kalendar. Kishte përpara një vit, d.m.th. 365 ditë. Prej tyre duhej të hiqte javën e parë (6 ditë), në të cilën ishte sjellë pa bërë gjë, ditët e pushimit, gjatë të cilave ai do të punonte në studio dhe s' do të paraqitej në Konvikt (afërsisht 40 ditë), muajt e verës, kur konviktoret do të largoheshin (92 ditë) si dhe disa ditë kur mund të ishte i sëmurë apo me ndonjë shërbim (ta zëmë 20 ditë); pra mbeteshin 238 ditë efektive. Sipas kësaj llogarie të thjeshtë, atij i duhej të fitonte diçka më shumë se katër zemra në ditë ($1000 : 238 = 4.2$).

U ndie i kënaqur me llogarinë, dhe objektivi, sipas të cilit duheshin pushtuar katër zemra në ditë, iu duk mëse i realizueshëm. Mandej, s' duheshin përjashtuar ditët e veçanta (apo edhe rastet e tilla) kur mund të realizonte më shumë se katër pushtime. (Për antipodet e këtyre ditëve, d.m.th. për ditët kur mund të kishte dështime, ai, tash për tash, as që e vriste mendjen.)

U ngrit nga kolltuku dhe ndezi një cigare që i shijoi si asnjëherë tjetër. Më pas u soll për njëfarë kohe nëpër studio, duke përjetuar me të gjithë qenien fillimin dhe etapat e Sulmit të Madh, që pa dyshim do të përbënte një prej çasteve më të rëndësishme të jetës së tij dhe me të cilin biografët do të merreshin jo pak në të ardhmen.

Ndjeu gjumë dhe u bë gati të shuante dritën e studios, kur befaz u kujtua se nuk kishte përcaktuar as emrin, as fytyrën e konviktores me të cilën do të niste Sulmin e Madh që, si çdo sulm, duhej të kishte një fillim, aq më shumë kur këtë operacion ai do ta fillonte dhe do ta mbaronte krejt i vetëm. U ul përsëri në kolltuk dhe hapi listat me emrat e të njëmijë konviktoreve. Mbylli sytë dhe pasi e kishte rrotulluar disa herë, e uli majën e lapsit diku mbi listat. Me emrin që do të shënonte maja e lapsit do të niste edhe Sulmin e Madh. I hapi sytë, duke u dridhur lehtë nga emocionet. Lapsi nuk shënonte asgjë: maja e tij kishte rënë diku në hapësirën mes dy emrave. E përsëriti lojën e tij – o Zot, ç'lojë e ankthshme! Përsëri maja e lapsit ra në hapësirë të bardhë. Edhe një herë tjetër. Përsëri e njëjta gjë. Edhe një herë. Edhe një herë...

Mbylli listat me një nervozizëm të lehtë dhe lapsin e hodhi tutje. Në fund të fundit, përse duhej të shqetësohej kaq shumë për një çështje të tillë të parëndësishme, siç ishte fillimi i Sulmit. Në mëngjes çdo gjë do të ishte e thjeshtë dhe e lehtë: ajo konviktore që do t'i afrohej e para, do të ishte edhe viktima e tij e parë.

U ngrit, mbylli studion dhe hyri në dhomën e gjumit.

Gjumi e zuri menjëherë.

Gjithë natën pa ëndrra me sulme dhe kështjella që binin.

Ora e madhe e murit ra gjashtë herë dhe, pa u shuar mirë goditja e fundit, Alfredi u ngrit nga shtrati. U la dhe u rroj me të shpejtë, duke u prerë paksa në faqen e djathtë, çka sipas tij nuk përbënte kurrfarë oguri të keq, përderisa pritej sa herë që rruhej; në të kundërtën, po të mos ishte prerë, do të kishte arsye të shqetësohej sadopak (megjithëse nuk ishte bestyt), duke e quajtur gjendjen e tij të sotme jo krejt të zakonshme, pra të pushtuar disi nga emocionet, prej të cilave ai dëshironte të ishte sa më i çliruar; në të vërtetë ai edhe sot ishte prerë (diku në faqen e djathtë) siç ishte prerë dje, siç ishte prerë para një jave dhe para një muaji, siç do të pritej nesër dhe pasnesër, pas një jave dhe pas një muaji, çka do të thoshte se edhe kjo ditë po hynte krejt natyrshëm mes ditëve të tjera të jetës së tij, megjithëse më pas kishte për t'u quajtur si një ditë krejt e veçantë: si dita e fillimit të Sulmit të Madh.

Hëngri me të shpejtë, piu kafënë e zakonshme të mëngjesit dhe u vesh pa i kushtuar ndonjë rëndësi të veçantë paraqitjes së jashtme, i bindur tashmë se ajo s'i hynte dhe aq në punë; në fillim po, sidomos në mëngjesin e Fjalimit, por edhe gjatë gjithë javës më pas. Kurse tani e rëndësishme, vendimtare, ishte të ruante imazhin e krijuar, atë imazh të mjegullt e disi ideal, por të mrekullueshëm, për të filluar dhe përfunduar një sulm si të tijin.

Ndezi një cigare dhe doli në rrugë. Sa pa njerëz, ndjeu një dridhje të lehtë në gjunjë. Ishin emocionet, armiqtë e tij të betuar, të cilëve u druhej aq shumë. Hyri në njërin prej klubeve të rrugës dhe, në këmbë, piu një konjak. Doli jashtë. Atë dridhjen e lehtë në gjunjë nuk e ndjente më. Dita ishte me diell dhe Alfredi u përpoq të përfytyronte se ç'mot

kishte qenë atë ditë kur kishte nisur rrethimi i Trojës. Padyshim ditë me diell duhej të kishte qenë. Të gjitha sulmet dhe pushtimet e mëdha ndërmerreshin në ditë të tilla. Më pas, kur ato përfundonin me sukses (ose edhe dështonin), niste një shi i imët, i shtruar, që zgjaste me javë të tëra, thua se donte të shpëlante gjithçka që përbënte çmimin e fitores (ose edhe të disfatës).

Pas pak godina e Konviktit iu shfaq para syve. Në çast u kujtua se gjysma e konviktove kishin mësim paradreke, gjysma tjetër – pasdreke. Çka do të thoshte se Sulmi i tij i Madh do të fillonte duke pasur përballë pesëqind kështjellëza femërore.

Ca re të bardha që u shfaqën befas në qiell dukeshin krejt të paafta për ta prishur magjinë e kësaj dite.

Në oborin dhe në korridoret e Konviktit s' dukej këmbë njeriu. Alfredi dëgjoi zhurmë në mensën aty pranë, u kujtua se ishte koha kur konviktoret hanin mëngjesin dhe vendosi të mbyllej në zyrë. Ende s'i kishte hapur dritaret e zyrës, kur trokiti dera: ishte një konviktoreshë me sy të mëdhenj e tepër të zgjatur anash, thua se dhe pak e do të dilnin jashtë orbitave. O Zot, ja dhe viktima e parë, tha Alfredi me vete, ndërsa përpigëj t'i zotëronte duart që kishin filluar sakaq t'i dridhe-shin lehtë.

Pastaj e shikoi me vërejtje vajzën, pa thënë asgjë. Ajo e ndjeu peshën e shikimit të tij dhe uli kokën.

– Mund të uleni, – tha Alfredi dhe tregoi me dorë njërin prej kolltukëve aty pranë.

– Falemnderit! – tha vajza. – Një problem të vogël kisha, një kërkesë...

– Uluni! – tha Alfredi. Toni i tij, kësaj radhe, kishte qenë disi urdhërues. – Kërkesën mund ta parashtroni edhe ndenjor.

Vajza u ul dhe kryqëzoi duart para gjunjëve. Alfredi e pa me bisht të syrit: kishte një trup të mrekullueshëm, në të ardhmen mund t'i shërbente edhe si një model i përkryer.

– Po ju dëgjoj, – tha Alfredi dhe përsëri ia nguli sytë.

– Desha të marr leje për sonte. Jam e ftuar në një mbrëmje miqsh.

Alfredi u ndie i përkëdhelur në sedër. Ajo vajzë mund të largohej për gjithë natën dhe vështirë ta merrte vesh kush. Ndezi një cigare dhe pyeti djallëzisht:

– Vetëm mbrëmje miqsh është?

– Thjesht mbrëmje miqsh.

– Jeni e re këtu në Konvikt?

- Po. Viti i parë.
- E keni parë skulpturën time?
- Po. Çdo ditë.
- Ju pëlqen?
- Po. Shumë.

- Do të dëshironit që ndonjëra prej skulpturave të mia të ardhshme të kishte fytyrën dhe trupin tuaj?

Vajza uli kokën dhe nuk foli. Dukej e tronditur. Alfredi mendoi se kishte ardhur çasti i përshtatshëm për ta filluar Sulmin e Madh: u ngrit nga vendi, fiku cigaren e porsandezur dhe iu afrua vajzës. Prej saj shpërndahej një aromë e çuditshme, e papërcaktuar. Alfredi ia ngriti kokën lehtë dhe afroi buzët e tij pranë të sajave. Vajza u ngrit në këmbë dhe e shtyu me forcë. Dukej e hutuar.

- Ju s'keni asnjë të drejtë të silleni kështu, - tha ajo dhe bëri të dilte.

- Ju lutem, prisni pak, - tha Alfredi, duke ndjerë dridhjen e beftë të gjunjëve. - Ndoshta u nguta, u tregova pak brutal, por edhe ju s'keni pse t'i maskoni ndjenjat tuaja, s'keni pse ta mbysni thelbin tuaj...

- Nuk po ju kuptoj, - tha vajza. Më shumë se e trembur, ishte e hutuar.

- Po ju më adhuroni! - tha Alfredi me zë të lartë.

- Ju shihni ëndrra ditën për diell! - tha vajza prerë dhe doli jashtë, duke tërhequr derën pas vetes.

Alfredi u këput në kolltuk. Ndezi një cigare, por ajo iu duk tepër e hidhur, ndaj e fiku sakaq. Ja se si filloi edhe sulmi i famshëm, Sulmi i tij i Madh: me një dështim. Po, po, me një dështim të plotë! Ndoshta ishte ngutur, kishte sulmuar tepër shpejt dhe krejt ballazi, pa organizuar më parë rrethimin, pa ndjekur një taktikë të caktuar që mund të përpunohej pas një njohjeje të kundërshtarit. E megjithatë, dreqi e mori, s'duhej të mërzitej kaq shumë, ishte vetëm fillimi; kishte përpara gati një vit të tërë, dhe gjatë kësaj periudhe do të kishte kohë e mundësi ta kthen-te në fitore edhe këtë dështim të parë. Ndezi një cigare tjetër dhe u ndie më mirë. Befas trokitën përsëri: ishte zonjusha Z.

– Ka vdekur rojtari i Konviktit! – tha ajo sapo hyri.

Alfredi ndjeu një shtrëngim të beftë në gjoks: gjatë gjithë këtyre ditëve as që ishte kujtuar për rojtarin.

– Kur? – pyeti ai.

– Si duket, mbrëmë. Sot duhet varrosur.

– Ku vdiq?

– Këtu në Konvikt. Në dhomën e tij. Në mëngjes herët e gjetën të shtrirë në shtrat. Kujtuan se ishte në gjumë...

– Varrimin duhet ta organizojmë ne? – pyeti Alfredi.

– Po, – tha zonjusha Z., – ai ishte njeri pa njeri.

– Tërhiqni nga fondi i Konviktit të gjitha paratë që duhen për varrim, – tha Alfredi. – Të porositen konviktoret që të marrin pjesë në ceremoninë e varrimit.

Zonjusha Z. deshi të shtonte edhe diçka tjetër, por Alfredi tregoi me dorë derën e zyrës. Biseda quhej e mbyllur.

Në drekë qielli u vrenjt papritur dhe, pak minuta para varrimit, nisi një shi i dendur që lagu gjithçka. Tek shihte kolonën e gjatë të konviktoreve që hiqej zvarrë në varrezën e përbaltur, Alfredi e ndjeu se kërkesa e tij për pjesëmarrjen e tyre në këtë varrim kishte qenë krejt absurde, siç kishte qenë absurde gjithë kjo ditë.

Tetori kaloi shpejt, si një ëndërr, dhe ditën e tij të fundit (ishte e martë) Alfredi vërejti me tmerr se nuk kishte realizuar as edhe një fitore, as edhe një pushtim, kur, sipas planit të hartuar në fillim, muaji duhej të ishte mbyllur me (të paktën) 104 pushtime, sepse sipas një llogarie të thjeshtë: duke hequr ditët e pushimit (4 ditë), ditën pas vdekjes së rojtarit të Konviktit (ditë në të cilën Alfredi nuk kishte ndër-marrë asnjë sulm), si dhe duke patur parasysh faktin se ky muaj ishte 31-ditësh, mbeteshin 26 ditë efektive ($31 - 5 = 26$), të cilave u përkonte një mesatare prej 4 pushtimesh në ditë. Por, në të vërtetë, Alfredi s'kishte realizuar as edhe një pushtim, as edhe një fitore, duke e vënë kështu para një pikëpyetjeje të madhe ëndërrën e njëmijë pushtimeve. Jo se s'kishte vepruar gjatë këtij muaji, madje kishte qenë tepër aktiv e këmbëngulës, duke realizuar një mesatare prej 5 sulmesh në ditë, çka do të thoshte se gjatë gjithë muajit kishte ndërmarrë 130 sulme ($26 \times 5 = 130$). Por të 130 sulmet kishin patur një përfundim: dështimin. Dhe tash, i fundosur në kolltukun e butë të zyrës, duke ndjekur shiun monoton që s'kishte pushuar gjatë gjithë këtyre ditëve, Alfredi përpiqej të analizonte shkaqet e disfatës, të cilën ai as që e kishte çuar nëpër mend, të paktën në të tilla përmasa.

Gjatë gjithë muajit, në të gjitha ditët, ai kishte qenë më se i bindur se të njëmijë konviktoret e adhurorin. Kishte pasur raste kur e kishte vënë në dyshim diçka të tillë (sidomos netëve, kur gjumi s'e merrte deri vonë), por me të zbardhur mëngjesi, dyshimet e tilla kishin rënë menjëherë poshtë. Në çdo hap që bënte korridoreve e oborrit të Konviktit ndjente adhurimin e turmës. Adhurim që shfaqej hapur, krejt hapur madje, herë-herë deri në paturpësi; adhurim që ishte konk-

retizuar me kushedi sa shikime joshëse e plot nënkuptime, me dhjetra e dhjetra darka e kafe të pira me konviktoret, me sa e sa letra të ndryshme e domethënëse (mbi 100 të tilla kishte të ruajtura në dosjen e tij). Disa herë Alfredi e kishte pyetur veten se mos ky adhurim ishte i rremë, se mos ishte pjellë e iluzioneve të tij, ose, thënë më troç: mos shihte ëndrra me sy hapur? Por, gjithsesi, s'mund të ishte kështu: provat, faktet që ai i grumbullonte dhe i verifikonte çdo ditë, ishin kokëforta. Gjithashtu, në jetën e përditshme ai e quante veten si një njeri realist e praktik (kështu mendonin edhe të tjerët për të).

Atëhere, përse kishte dështuar?

Ndoshta ishte ngutur. Duke pasur një besim të tepruar në vete, e kishte parashikuar gjithçka të mundur e tepër të lehtë, kur në të vërtetë kishte ndodhur krejt ndryshe: të rrezikuara nga anonimati në atë bashkësi të madhe, shpirtrat femërorë ishin ndërlikuar qëllimisht, me synimin për të fituar sadopak identitet, duke u bërë kështu të pakuptueshëm (d.m.th. të papushtueshëm) për kujdestarin.

Ndoshta plani i tij ishte marrë vesh, ishte nuhatur (thua instinktivisht?) nga të njëmijë konviktoret, dhe në mes tyre ishte lidhur sakaq një pakt i heshtur për ta dështuar këtë plan.

Ndoshta në mes të njëmijë konviktoreve nuk kishte kurrfarë pakti të heshtur, por përkundrazi, një armiqësi e pashpallur kishte hedhur rrënjë mes tyre, një armiqësi e gatuar me xheloz, cmirë, egoizëm e ligësi, shkak për të cilën ishte pikërisht ai, Alfredi.

Ndoshta të njëmijë konviktoret, duke e nuhatur instinktivisht synimin satanik të kujdestarit të tyre, kishin hartuar sakaq njëmijë kundraplane, hë për hë mbrojtëse, por me perspektivë sulmi, më pas. Të ndodhura përballë një rreziku të tillë, siç ishte Sulmi i Madh Frontal i Alfredit, të njëmijë konviktoret kishin nxituar të nxirrnin armët e tyre, të cilat deri më tash i kishin kujtuar të ndryshkura, ngaqë s'u kishin hyrë në punë dhe s'i kishin përdorur. Armë të tilla si joshja, në fillim, e më pas mospërfillja e ndërlikimi (deri në moskuptim), tingëllonin krejt anakronike në marrëdhëniet që

kishin ato me gjahtarët e konviktoreve, kurse në rastin e Kujdestarit ndryshonte puna.

Ndoshta kishte dështuar sepse nuk kishte qenë në gjendje të ruante imazhin e krijuar në fillim, atë imazh të cilin e kishin adhuruar dhe dashuruar të njëmijë konviktoret.

Ndoshta qëndronte njëri prej këtyre shkaqeve. Ndoshta të gjithë së bashku.

Mbështeti kokën mbi grushte dhe u ndie i lodhur për ta vazhduar më tej arsyetimin. Një gjë ishte më se e qartë: plani i tij për pushtimin e të njëmijë shpirttrave femërorë duhej quajtur i dështuar tashmë. Vendosi ta ndryshonte objektivin: ta zbriste nga njëmijë në njëqind numrin e konviktoreve që do t'i nënshtroheshin Sulmit të tij. Sipas një llogarie të thjeshtë, duke hequr muajin e parë (26 ditë efektive), në të cilin s'kishte realizuar as edhe një pushtim, ditët e pushimit (afërsisht 36), ditët kur mund të ishte i sëmurë apo me ndonjë shërbim larg Konviktit (ta zëmë 20), si dhe tre muajt e verës kur konviktoret do të largoheshin (92 ditë), mbeteshin 191 ditë efektive ($365 - 26 - 36 - 20 - 92 = 191$), çka do të thoshte se i duhej të fitonte diçka më pak se një zemër në dy ditë ($191 : 100 = 1.9$).

Kur doli nga zyra ishte kohë dreke dhe korridoreve të Konviktit s'duhej këmbë konviktoreje. Te shkallët ndoqi me bisht të syrit skulpturën e tij, që iu duk më e vogël se herët e tjera. Oborrin e përshkoi me të shpejtë, thuajse me vrap. Kur doli në rrugë, u kujtua se gjatë gjithë muajit as që e kishte çuar ndonjëherë nëpër mend kasetën e vockël që ruante pavetëdijen e tij.

Ndoshta edhe te ky fakt duhej kërkuar ndonjë prej shkaqeve të dështimit.

Alfredi nuk e gjeti kasetën aty ku e kishte lënë para një muaji, as në ndonjë vend tjetër. Ktheu përmbys gjithë studion, mandej dhomën e gjumit, hetoi të gjithë dollapët, sirtar për sirtar. Më pas, pyeti gruan.

– Para disa ditësh ka luajtur vajza me një kasetë. Ndoshta ka qenë ajo, – tha gruaja me shpërfillje.

– Si, vajza!? Me kasetën time?

– Nuk është hera e parë që vajza luan me sendet e tua, – tha gruaja. Qetësia e saj ishte shkatërruese. Me siguri, në gjithë atë këmbëngulje të Alfredit për ta gjetur kasetën, shihte mundësinë e ekzistencës së ndonjë femre.

– Ajo kasetë më duhet medoemos, – tha Alfredi.

– Kaq e rëndësishme qenka për ty? – pyeti gruaja pa e humbur qetësinë e fillimit.

– Thashë që më duhet medoemos!

– Atëhere, gjeje!

– Ku ta gjej, dreqi e mori! S'lashë vend pa kërkuar.

– Pyete vajzën. Ndoshta të nxjerr nga situata.

Alfredi pa me bisht të syrit nga gruaja. Ndoshta tallej, ndoshta jo. Vajza ishte vetëm tre vjeçe dhe fjalët i hante e i shtrembëronte të gjitha. Sidoqoftë, le ta provonte njëherë.

Gruaja doli edhe pas pak hyri me vajzën që ecte duke u tundur, me duart para si somnambule.

– Ku është kaseta, shpirti i babit?

– Kus estë tateta?

– Ajo kutia e vogël, shpirt. Si paketa e cigareve të babit.

– Te pia e marimangës.

– Te shtëpia e marimangës, – përktheu gruaja në çast.

Zbritën poshtë dhe hetuan të gjitha kthinat e shtëpisë, por s'gjetën gjë. Kaseta ishte zhdukur.

– Kaq e rëndësishme ishte ajo kasetë? – pyeti gruaja, më seriozisht kësaj radhe.

– Po, – u përgjigj Alfredi.

– Çfarë kishe regjistruar në të?

– Pavetëdijen time.

– Çfarë?! – Gruaja shtangu e çuditur. Mandej iu afrua Alfredit dhe ia mbështeti kokën në gjoks.

– Ndoshta bën mirë të largohesh nga Konvikti, – tha ajo.

– Pse?

– Ke ndryshuar shumë, ke filluar të lodhesh...

– Nuk është ashtu, – tha Alfredi rrëmbyeshëm dhe u ngrit nga vendi. – Nuk kam qenë ndonjëherë më mirë se tani.

Gruaja nuk foli më.

Alfredi u mbyll në studio dhe ndenji aty gjithë pasdreken, pa bërë asgjë.

Të nesërmen, ditën e parë të nëntorit, Alfredi e filloi Sulmin që në mëngjes, i bindur se kësaj radhe gjithçka do të ishte më e thjeshtë dhe më e lehtë. Objektivi i ri, sipas të cilit duhej pushtuar një zemër në dy ditë, duhej plotësisht i realizueshëm. Tani Alfredi mund të tregohej më i kujdesshëm e më i matur, nuk kishte asnjë arsye të ngutej e të hidhte hapa të nxituar, siç kishte bërë jo rrallëherë muajin e kaluar. Dy ditë nuk ishin pak për të organizuar dhe përfunduar me sukses një sulm. Të gjitha dështimet e muajit të kaluar i kishin vlejtur, ato kishin qenë një përvojë jo e pakët për të; tani duhej llogaritur çdo veprim, duhej matur mirë çdo hap, sado i parëndësishëm në dukje, sepse kishte pasur jo pak raste gjatë muajit të kaluar kur kishte qenë fare pranë fitores, por kishte mjaftuar një hap i nxituar, një gabim i vogël, që gjithçka të shembej.

Këto mendonte Alfredi, ndërsa sillej korridoreve të Konviktit. Por shpejt e kuptoi se nuk do ta kishte aq të lehtë e të thjeshtë sa ç'e kishte parashikuar në fillim. Përkundrazi, objektivi i ri kishte lindur probleme e vështirësi të reja, të pavëna re më parë: për Alfredin nuk ishte aspak e lehtë që në atë mijëshe fytyrash të bukura e shpirtrash ulëritës të veçonte e të zgjidhte njëqind. Gjithë javën e parë të muajit të tretë të punës së tij si kujdestar, u soll korridoreve të Konviktit, duke vëzhguar, skicuar e regjistruar fytyra konviktoresh, veprim ky që ngjalli jo pak dyshime mes tyre.

Më në fund, arriti ta veçonte një qindëshe dhe menjëherë filloi Sulmin.

Por shpejt u ndodh përballë vështirësish të reja, të parashikuara. Ideja e përzgjedhjes që, siç duket ishte marrë vesh nga konviktoret, bëri që ato të ndërlikoheshin edhe

më, duke u bërë edhe më të pakuptueshme (d.m.th. të papushtueshme). Dhe ishin pikërisht të njëqind konviktoret e seleksionuara që joshnin e ftonin krejt hapur (herë-herë edhe paturpësisht), duke e nxitur Alfredin të ndërmerre sulme të njëpasnjëshme. Por atëhere kur ai përgatitej të shijonte triumfin, pikërisht atëhere vinte e beftë, e hidhur disfata.

Ditët kalonin dhe ai kishte filluar t'i humbiste qetësinë e besimin në vetvete. Gjatë këtyre ditëve s'kishte punuar, s'kishte gdhendur asgjë. Gjithë kohën e lirë ishte marrë me hartimin dhe strategjinë e planeve të pushtimit, duke i përjetuar sulmet dhe disfatat. Ndërsa koha kishte rrjedhur paturpësisht shpejt, si rëra nëpër gishtërinj.

Krejt tinëzisht, si një puthje në kohë kolere, erdhi edhe dita e fundit e nëntorit. Ishte një ditë e pezullt, me ca re të zeza e të dendura që të dukej sikur i mbaje mbi shpinë. Alfredi largoi paksa perden e zyrës dhe oborri i Konviktit plot pellgje uji iu duk i shëmtuar. Lulet ishin tharë e shkelur të gjitha (që me vdekjen e rojtarit, për to s'ishte kujdesur kush), ndërsa skulptura aty në mes, ashtu e lagur dhe e përbaltur, dukej si një tallje.

Alfredi u zhyt në kolltukun e tij dhe ndezi një cigare. Ditët kishin kaluar shpejt, tepër shpejt, duke regjistruar vetëm disfata për të. Vetëm disfata. Asnjë fitore. 14 sulme kishte ndërmarrë gjatë këtij muaji (në fakt, sipas llogarisë së bërë në fillim të nëntorit, numri i sulmeve mujore duhej të ishte $13 (26 : 2 = 13)$, por ai qëllimisht i ishte shmangur këtij numri për arsyen e thjeshtë se kohët e fundit kishte filluar të ndihej disi bestyt; sulmet kishin qenë të menduara mirë që më parë dhe të detajuara deri në imtësi, që në vështrim të parë dukeshin krejt të panevojshme. E megjithatë, të 14 sulmet kishin pasur një përfundim: disfatën.

Vendosi ta korrigjonte përsëri objektivin: do ta zbriste nga njëqind në dhjetë numrin e konviktoreve që duheshin pushuar. Sipas një llogarie të thjeshtë që e bëri aty për aty, i takonte të pushtonte diçka më shumë se një zemër në 25 ditë, ose përafërsisht një konviktorë në muaj. Nxori lapsin dhe deshë të shënonte diçka, kur trokiti dera. Ishte zonjusha Z.

– Mund të hyj? – pyeti ajo, duke futur gjysmën e trupit brenda zyrës.

– Ju keni hyrë tashmë, – tha Alfredi.

Zonjusha Z. u gjend keq dhe nuk foli. Dera pas shpinës së saj ishte gjysmë e hapur.

– Mbylleni derën dhe uluni, – tha Alfredi, duke i mëshuar lapsit mbi tryezë. Maja e tij u thye me një krismë të lehtë. Zonjusha Z. u ul përballë Alfredit, duke hedhur këmbën e djathtë mbi të majtën. Fundi i saj i ngushtë rrëshqiti sipër gjunjëve, por ajo s'bëri asnjë përpjekje për t'i mbuluar sadopak kofshët e zbuluara.

– Më mirë kështu, – tha Alfredi përhumbshëm.

– Si më mirë kështu? – pyeti e befasuar zonjusha Z.

Alfredi fërkoi sytë me të dyja duart dhe qeshi.

– Nuk e kisha me ju. Fola me veten.

– Ju po talleni! Ju gjithmonë talleni me mua. Kurrë nuk më merrni seriozisht, – tha zonjusha Z. Pas pak edhe mund të qante.

– Më falni, nuk desha t'ju fyej, – tha Alfredi, duke u përpjekur t'u jepte doza sa më të mëdha sinjeriteti fjalëve që thoshte. Më pas afroi paketën e cigareve dhe mori një.

– Mund ta ndez edhe unë? – tha papritur zonjusha Z.

– Po ju sikur nuk e pini! – bëri të befasuarin Alfredi, duke zgjatur paketën drejt saj.

– Rrallë, tepër rrallë ndez ndonjë, – tha zonjusha Z. dhe mori një cigare nga paketa e zgjatur.

Alfredi ia ndezi. Zonjusha Z. u mbështet në kolltuk dhe filloi të thithte me afsh cigaren e ndezur. Nga mënyra se si e mbante cigaren në gishtërinj, si e thithte dhe si e nxirrte tymin më pas, në rrathë gati të barabartë e që këputeshin mandej në ajër, Alfredi e kuptoi menjëherë që një rit të tillë ajo nuk duhej ta praktikonte aq rrallë sa kishte shpallur në fillim.

Për disa çaste nuk foli asnjëri. Papritur, zonjusha Z. ndërroi pozicionin e këmbëve (d.m.th. hodhi të majtën mbi të djathtën) dhe tha:

– E dini se këto kohët e fundit Konvikti nuk është më ai i pari?

– Jo, – tha Alfredi krejt automatikisht.

– Disiplina ka rënë, rregullorja nuk zbatohet, konviktoret janë shturur.

– Në ç'kuptim janë shturur konviktoret? – pyeti Alfredi.

– Si në ç’kuptim?! – zonjusha Z. u hutua për një çast, pastaj e mori veten menjëherë. – Në kuptimin e shturjes. Gati çdo natë fusin gjahtarë brenda.

– Ju keni prirjen t’i dramatizoni gjërat, – tha Alfredi, duke shtypur cigaren në tavëll.

– Unë nuk bëj drama, – tha e fyer zonjusha Z. – Unë them të vërtetën. Më kanë sinjalizuar. Disa herë i kam parë gjahtarët edhe me sytë e mi. Ne duhet të veprojmë, madje sa më ashpër dhe sa më shpejt. Nesër kam frikë se do të jetë tepër vonë.

Alfredi ndjeu një mpirje të papritur në gjymtyrët. U shtriq edhe më në kolltukun e tij dhe ndezi një cigare tjetër. Për disa çaste, në zyrë ra përsëri heshtja. Pastaj Alfredi u ngrit nga kolltuku dhe pyeti:

– E dini se kemi konviktoire të bukura?

– Janë për vete! – tha e hutuar, krejt automatikisht, zonjusha Z.

– A mund të më thoni se cilat janë dhjetë konviktoiret më të bukura?

– Ju po talleni me mua! – zonjusha Z. u ngrit në këmbë. Dridhej. – Ju po talleni! Ju gjithmonë jeni tallur. Unë do të ankojem lart.

Alfredi qeshi me zhurmë. Zonjusha Z. doli thuajse me vrap nga zyra, duke tërhequr derën me forcë pas vetes. Alfredi mbështeti bërrylat mbi tavolinën e tij të punës dhe foli me zë:

– E pra, cilat janë dhjetë konviktoiret më të bukura?

Objektivi i ri, ai i pushtimit të dhjetë konviktoreve, iu duk Alfredit plotësisht i realizueshëm. Afati prej 26 ditësh, që i përgjigjej çdo pushtimi, krijonte kohë, hapësirë e mundësi për të zgjedhur, studjuar e përpunuar strategji e taktika sa më të sofistikuar e sa më efikase, që do të mbështeteshin pa dyshim edhe mbi përvojën e gabimeve dhe dështimeve të mëparshme, me synimin për të mos i përsëritur më ato. Por shpejt, shumë shpejt, Alfredi e kuptoi se përsëri nuk do ta kishte aq të lehtë sa ç'ë kishte parashikuar. Përkundrazi. Sepse, së pari, ishte tmerrësisht e vështirë që në atë turmë prej njëmijë vajzash të veçoje dhjetë më të bukurat; së dyti, ideja e seleksionimit të mëtejshëm (që u nuhat menjëherë – ndoshta instinktivisht – nga të njëmijë konviktoret) bëri që shpirtrat femërorë të ndërlikoheshin deri në absurd.

Që në ditët e para të dhjetorit, kur Alfredi endej korridoreve të Konviktit për të kryer seleksionimin, e kishte kuptuar se plani i tij s'përbënte më sekret për turmën e konviktoreve. Ato sillleshin shkak e pa shkak korridoreve (si në një paradë mode), i kushtonin kujdes si kurrë më parë paraqitjes së tyre të jashtme, duke ndërruar thuajse ditë për ditë veshjet dhe duke provuar modele të reja të krehjes së flokëve, hynin e dilnin pa kurrfarë arsyeje në zyrën e Alfredit ose i shfaqeshin përballë korridoreve të errëta të Konviktit, thjesht për t'i tërhequr vëmendjen, për t'i dëshmuar bukurinë e tyre. Në rrethana të tilla, kur bukuria dhe joshja femërore shfaqeshin krejt paturpësisht, gati-gati pa pyetur për kurrfarë norme dhe etike, Alfredi e kishte tepër të vështirë të kryente seleksionimin. Iu deshën 10 ditë (as që i kishte parashikuar e planifikuar kaq shumë) derisa veçoi dhjetë

konviktoret që, për mendimin dhe për shijen e tij, ishin më të bukurat. Si e quajti të përfunduar këtë etapë (d.m.th. seleksionimin), u ndie disi më mirë dhe krijoi besim në vetvete se, kësaj radhe, edhe mund të ngadhënjente.

Në një prej ditëve kur merrej me seleksionimin, u kujtua për kasetën e humbur, por shpejt e kuptoi se ajo tashmë as që i hynte në punë. Imazhin e fillimit, të cilin Alfredi kishte menduar ta ruante sa më shumë dhe ta përdorte si aleat besnik gjatë gjithë etapave të Sulmit të Madh, e kishte shkatërruar thujse me duart e veta.

Sidoqoftë, duhej besuar dhe shpresuar ende.

Në ditët e hirta të fundit të dhjetorit dhe fillimit të janarit, kur Konvikti, pa të njëmijë konviktoret që ishin larguar për pushimet e dimrit, dukej më i zyrtë se kurrë, Alfredi e ndjeu dhe ia pohoi vetes se kishte dështuar. Ëndrrës së tij të çmendur (deri para pak muajsh as që e kishte quajtur ëndërr, të çmendur jo se jo) i kishte ardhur fundi. Në të vërtetë, edhe etapat e njëpasnjëshme të seleksionimit (nga njëmijë në njëqind e, më pas, në dhjetë), s'kishin qenë gjë tjetër veçse etapat e dështimit të tij, dështim që ishte bërë edhe më i prekshëm ditët e fundit, kur numri i konviktoreve që do t'i nënshtroheshin Sulmit ishte reduktuar në dhjetë dhe kur ai (Alfredi) kishte pandehur se në këtë moment gjithçka do të ishte më e lehtë dhe më e thjeshtë. Që në sulmin e parë të etapës së fundit (kishte qenë një e martë me diell që ishte shfaqur befas mes ditëve të zymta, ndërsa objekti i sulmit – një biondinë e mrekullueshme së cilës, tani s'ia kujtonte as emrin), Alfredi ishte ndjerë keq nga loja absurde që po i kurdisnin konviktoret (më vonë do ta kuptonte se kjo që ai quante lojë, për to ishte mënyrë ekzistence), pa qenë në gjendje t'i jepte një shpjegim të kënaqshëm asaj. Vetë biondina e kishte ftuar Alfredin në dhomën e saj dhe, më pas, kur ai, duke ndjekur logjikën e çastit, ishte hedhur në sulm, ajo ishte tallur me të, madje edhe e kishte fyer. Pak a shumë në të njëjtën mënyrë ishin zhvilluar ngjarjet edhe me nëntë konviktoret e tjera, derisa kishin ardhur këto ditë të hirta të fundit të dhjetorit dhe fillimit të janarit, kur në godinën bosh të Konviktit ai (Alfredi) ishte i detyruar ta pranonte dështimin e tij që bëhej edhe më i plotë, po të merrej parasysh fakti se gjithë këto kohë nuk kishte punuar, nuk kishte gdhendur thujtë asgjë.

Në njërën prej këtyre ditëve të hirta, që i ngjisnin njëra-tjetrës deri në bezdi, Alfredi u kujtua për konviktoren e bukur me emrin Terezë D. dhe për poezitë që ajo ia kishte dhënë para shumë kohësh, krejt në fillim (deri atë çast as që ishte kujtuar dhe as që kishte patur kohë të merrej me ato vjersha dhe me autoren e tyre). Hetoi nëpër sirtarët e tryezës së tij të punës, derisa i gjeti. I lexoi me një frymë. U befasua. I lexoi edhe një herë. U mrekullua. Kishte kohë pa ndjerë fërgëllima të tilla në shpirt, fërgëllima që kishte aftësinë t'i krijonte vetëm magjia e artit. E kuptoi menjëherë sekretin e mrekullimit të tij: në ato poezi kishte singeritet femëror deri në dhimbje. Mes aty vargjeve shpirti pulsonte si i gjallë: përpëlitej, vritej e ringjallej, qante e shpresonte, ulërinte e kërkonte ndihmë, si të desh t'u thoshte të tjerëve: "Më ndihmoni, jam në agoni, mos më lini të vdes!"

Të tjerëve?! Po pse të tjerëve? Alfredi zuri kokën me duar. Pse të tjerëve, pra? Ato vargje i ishin dhënë atij dhe vetëm atij, askush tjetër s'i kishte lexuar më parë. Tani atij nuk i kujtohej në e kishte pohuar një fakt të tillë Terezë D., por për këtë ai ishte i bindur. Ato poezi i kishte lexuar ai dhe vetëm ai, askush tjetër. Shpirti i Terezë D. kërkonte ndihmë prej tij, vetëm prej tij dhe askujt tjetër; ndërsa ai i kishte harruar aty në sirtar (poezitë dhe shpirtin e saj), i zënë me ëndrrën e çmendur të sulmeve e të pushtimeve të mëdha. E kishte kërkuar shpëtimin e shpirtit të tij në plotësimin e një ëndrre të çmendur e absurde, kur e kishte pasur aq pranë: mbyllur në sirtar. Me siguri, ai shpirt i mrekullueshëm që thirrej Terezë D., vlente më shumë se të 999 shpirtat e turmës të marra sëbashku. Ndërsa Alfredi e kishte mbyllur në sirtar. E kishte harruar atë shpirt të mrekullueshëm, e kishte fyer me mospërfilljen e tij. E kishte fyer pikërisht atëhere kur Terezë D. kishte pritur e shpresuar aq shumë prej tij, duke ndjerë edhe ngjashmërinë mes tyre.

Por, ndoshta nuk ishte vonë.

Duhej shpresuar.

Pas pak ditësh, Terezë D. do të vinte në Konvikt.

Aty nga mesi i janarit filluan të ktheheshin konviktoret e para. Bashkë me to erdhi edhe një dëborë e dendur dhe e lagësht, që për pak orë ktheu në baltovinë çdo cep të oborrit. Në një prej këtyre ditëve, ndërsa sodiste që nga dritarja e zyrës kthimin e konviktoreve, Alfredi dalloi mes tyre Terezë D. E kërrusur nga pesha e dy valixheve të mëdha, ajo dukej e vogël dhe e vetmuar. Alfredi ndjeu papritur dhimbje për të dhe një dridhje e lehtë ia përfshiu kupat e gjurit. Siç duket kishte rënë në dashuri, çka as ia kish marrë mendja para disa muajsh. Pas pak orësh (llogariti kohën e mjaftueshme gjatë së cilës Terezë D. mund të bënte një dush e të pushonte) e thirri konviktoresh në zyrë. Terezë D. u ul në njërin prej kolltukëve dhe nuk foli. Alfredit iu duk e hequr dhe e lodhur, por sidoqoftë shumë e bukur.

– U kthyet përsëri? – pyeti ai dhe ndjeu në çast absurditetin e pyetjes.

Terezë D. nuk u përgjigj.

– I lexova poezitë tuaja, ishin të mrekullueshme, – tha Alfredi me një frymë dhe turbullt u kujtua se, pak a shumë, një cilësim të tillë kishte përdorur dikur edhe Terezë D. për skulpturën e tij.

– Falemnderit, – tha Terezë D. Në fytyrën dhe në tërë qenien e saj kishte shpërfillje dhe kotësi. Alfredi u ndie keq dhe për disa çaste nuk folën asnjëri. Pastaj ai ndezi një cigare dhe e theu përsëri heshtjen:

– Poezitë ishin të mrekullueshme. Më falni që i mbajta kaq gjatë në sirtar. Por po ta dija se ishin të tilla...

– S'ka problem, – tha Terezë D. – Ju ishit i zënë me plane të mëdha, nuk kishit kohë të merreshit me vogëlsira të tilla.

Alfredi e ndjeu deri në palcë hidhëtinë e këtyre fjalëve, por nuk tha gjë. Përsëri për disa çaste nuk folën asnjëri dhe përsëri Alfredi e theu i pari heshtjen:

– Keni shkruar ndonjë gjë të re gjatë kësaj kohe?

– Jo.

– Po në të ardhmen? Ju keni talent...

– Ku i dihet. Por edhe nëse shkruaj, do t'i mbaj për vete.

– Gaboheni! Ky nuk është destinacioni i artit. Edhe arti, si çdo prodhim, duhet të ketë klientelën e vet, konsumatorët e vet. Artisti nuk duhet të jetë varr, por djep i artit të tij. Më kuptoni, besoj?

– Ju kuptoj dhe ndoshta keni të drejtë. Por në rastin tim problemi është krejt i thjeshtë: unë as që kam pretenduar dhe as që pretendoj të jem artiste.

– Gaboheni! Jua them sinqerisht që gaboheni. Në poezitë tuaja ka art të vërtetë. Më besoni, e njoh jo pak poezinë...

– Edhe njëherë falemnderit, – tha krejt thatë Terezë D., pastaj krejt papritur u ngrit nga vendi dhe shpërtheu: – Jo, ato nuk janë art. Ato janë shfrime të shpirtit tim, thjesht fletë ditari, të cilave tani as unë vetë s'u besoj. Më kuptoni, mjeshtër?

– Po në fund të fundit ky është arti, – tha Alfredi me zë të ulët dhe krejt i pasigurt, si t'i fliste vetëm vetes.

– Jo, ky nuk është arti. Arti është diçka tjetër. Jo çdo fletë ditari, jo çdo lektisje e vajtim shpirti mund të jenë art. Edhe një fëmijë qan, madje më sinqerisht se kushdo tjetër.

Terezë D. heshti dhe u ul përsëri në kolltuk. Fytyra i ishte skuqur paksa dhe Alfredit i pëlqeu më shumë se kurrë. Nuk folën asnjëri. Më pas Terezë D. rrëmoi nëpër çantën e saj, gjeti një cigare dhe e ndezi.

– Ju e pini cigaren?! – pyeti i habitur Alfredi.

– E kam filluar kohët e fundit, – tha Terezë D. duke e thithur cigaren me afsh. – Është një prej normave të Konviktit edhe kjo.

Alfredi nuk foli. Terezë D. e thithi edhe një herë cigaren (ngjante sikur e kafshonte) dhe vazhdoi:

– Më duket se jua kam thënë në fillim që Konvikti ka disa kushte, të cilave është e pamundur t'u shmangesh. Njëri prej tyre është edhe cigarja...

– Por poezitë tuaja të mrekullueshme dëshmojnë se ju, se shpirti juaj u kanë shpëtuar kushteve e normave të pashpallura të Konviktit, – tha Alfredi me patetizëm.

– Po si t'ia bëj që unë tani nuk u besoj as vetë atyre poezive të mrekullueshme, – tha Terezë D., duke i mëshuar pamëshirshëm fjalës «mrekullueshme». – Madje, jua them sinqerisht, ndihem e turpëruar prej tyre.

– Si? Ju ndiheni e turpëruar nga vetja juaj?!

– Kjo mund t'i ndodhë kujtdo. Mandej, unë e kisha fjalën për një çast, për një gjendje të caktuar.

– Nuk e kuptoj dhe nuk e pranoj gjykimin tuaj, – e ndërpreu brutalisht Alfredi. – Ju ndiheni e turpëruar nga pjesa juaj më e sinqertë, më e mirë, më e bukur. Nëse ju kam kuptuar drejt, ju ndiheni e turpëruar nga vetë thelbi juaj.

– Po, drejt më keni kuptuar.

– Kjo është paradoksale! Kjo është absurde! – tha Alfredi me zë të lartë.

– Ndoshta, edhe jeta e tillë është, – tha Terezë D., – një grumbull paradoksesh e absurditetesh, të cilat e ndjekin njeriun që nga lindja deri në vdekje. Herë-herë vendoset një farë rregulli e rendi, por sa nisim të besojmë e të shpresojmë në diçka, u vjen radha paradoksit e absurdit, që e marrin sakaq për dore jetën tonë, krejt si prindërit fëmijën; veçse ata, në ndryshim nga prindërit e fëmijës, janë shpeshherë tekanjorë e jo dashamirës.

Alfredi ishte bërë një me kolltukun. Ishte hera e parë që ndiqte me kaq interes e vëmendje arsyetimet e një femre. Ai gjithmonë e kishte nënvleftësuar potencën intelektuale të seksit të bukur, te femra gjithmonë kishte parë një kukull, një mjet argëtimi. Kurse Terezë D. po e mrekullonte. Në heshtje mallkoi veten për gjithë atë kohë që ishte treguar mospërfillës me të dhe që kishte qëndruar larg saj.

– Ndoshta ju mërzita? – tha Terezë D.

– Përkundrazi! – tha Alfredi me një frymë. – Ju po më befasoni gjithnjë e më shumë.

Pas këtyre fjalëve, që Alfredit iu dukën gjithsesi të shpejtura ngaqë mund të linin shteg për keqkuptime, në zyrë ra heshtja. Dëgjohej vetëm zëzërима e një mize që përpiquej të dilte nga palat e njërës prej perdeve të najlonta. Terezë D. ndezi një cigare tjetër.

– Pra, sipas jush, vjen një çast kur njeriu ndihet i turpëruar nga vetë thelbi i tij, – e prishi heshtjen Alfredi. Fjalët e tij tingëlluan edhe si pyetje, edhe si pohim.

– Ndoshta kështu është, – tha Terezë D., – megjithëse unë fola thjesht për vete, nuk abstragova. Solla vetëm përvojën time.

– Por, zakonisht, njerëzit ndihen të penduar e të turpëruar për çaste të errëta të jetës së tyre, ose thënë ndryshe për atë pjesë të pasinqertë e të keqe të vetes së tyre, – ndërhyri i pasigurt Alfredi.

Terezë D. thithi cigaren (përsëri u duk sikur e kafshoi), largoi tymin me dorë dhe tha:

– Më falni, por më duket se gjykimi juaj është disi shkollaresk, klasik e tradicional. Unë thashë se vjen një çast kur njeriu ndihet i turpëruar nga thelbi i vet; nuk thashë nga pjesët e tij të sinqerta apo të pasinqerta, të mira apo të këqija...

– Pra, sipas jush, njeriu...

– Ju lutem, më lini të vazhdoj, – e ndërpreu Terezë D. – Ka kohë që njerëzit nuk i ndaj më sipas kategorive të tilla: të mirë e të këqinj. Kategorizime të tilla mund të përdoren për konviktet. Fare mirë mund të thuash Konvikt i mirë apo Konvikt i keq. Është ky Konvikt, mandej, që përpunon konviktoret e tij...

– Ju e zmadhoni deri në ekstrem ndikimin e Konviktit mbi anëtarët e tij, – e ndërpreu Alfredi, – ndërkohë që mohoni qëndresën që mund t'i bëjnë atij konviktoret.

– Deri para pak kohësh dyshime të tilla kam patur edhe unë, – tha e lodhur Terezë D. – Edhe unë kam besuar se njeriu mund dhe duhet ta ruajë thelbin e tij pa pyetur për tryshinë e Konviktit, por më pas jam ndjerë e zhgënjyer. Njeriu ndihet mosbesues ndaj thelbit të tij, madje edhe i turpëruar, pikërisht atëhere kur ky thelb është i ndryshëm nga thelbi i

Konviktit, e ndoshta edhe në kontradiktë me të. Më duket se çdo Konvikt ka një thelb të vetin, një thelb që vjen e ndryshon nëpër kohë. Dhe detyra e individit është që ta përpunojë thelbin e tij, t'ia përshtasë thelbit të Konviktit. Mjerë ai njeri që tregohet i paaftë në një proces të tillë!

– Po Konvikti është një institucion, nuk është një përbindësh, – tha Alfredi i pasigurt. – Me të edhe mund të luftohet, shembujt nuk kanë munguar...

– Unë e kam fjalën për njerëz të zakonshëm, jo për heronj, – e ndërpreu Terezë D., duke shtypur fundin e cigares në tavllën aty pranë. Në zyrë ra përsëri heshtja. Alfredi, pa e ditur as vetë se pse, hodhi sytë nga dritarja. Bora ishte shndërruar në shi dhe atje përjashta gjithçka dukej e zymtë. Terezë D. foli papritur:

– E dini se ka qenë një çast kur unë kam shpresuar në përmirësimin e Konviktit tonë?

– Kur? – pyeti Alfredi.

– Atëhere kur ju erdhët si kujdestar, – u përgjigj qetësisht Terezë D. – Në fillim, krejt në fillim. Atëhere kur vendosët në oborr skulpturën tuaj të mrekullueshme, kur mbajtët atë fjalim të hatashëm.

Alfredi u ndie i përkëdhelur në sedër. Ndezi një cigare dhe nuk foli.

– Ju duhet ta mbani mend se si ndryshoi Konvikti ynë ato ditë, – vazhdoi Terezë D. – Çdo gjë filloi të bëhej më e mirë, më e rregullt, më e pastër, aq sa ato ditë fillova të shpresoj se edhe thelbi i Konviktit mund të ndryshonte.

– Dhe si, nën ndikimin e thelbit tim? – pyeti gati instinktivisht Alfredi.

– Po, nën ndikimin e thelbit tuaj, mirë e thatë, – foli Terezë D.

– Po unë isha një. Si mund të ndikojë në thelbin, në frymën e Konviktit, – as pyeti dhe as kundërshtoi Alfredi.

– E vërtetë, ju ishit vetëm një, por ne ju adhurim në ato ditë. Ne, të njëmijë konviktoret, ju shihnim si perëndi në ato ditë. Po, po, si perëndi. Ne ju adhurim jo si mashkull, më kuptoni, se të tillë kishim plot pas kangjellave të Konviktit, por si frymë, si shpirt që, çuditërisht, i kishte shpëtuar

përçudnimit, kalbjes, prishjes. Duke ju adhuruar ju, ne besonim e shpresonim në shpëtimin tonë, të shpirttrave tanë. Pikërisht ato ditë edhe unë ua dhashë shpirtin tim në duar, d.m.th. vjershat e mia. Ku ta dija unë, ku ta dinim ne atëhere se ju kishit në kokë një plan aq diabolik, një ëndërr aq të çmendur. Në fillim, ju e luajtët për mrekulli rolin tuaj, porsì një aktor i vërtetë. Ku ta dinim ne atëhere se shpirti juaj ishte i kalbur, se ai mbahej me paterica të tilla, si fama, lavdia, opinionet. Si ta dija unë atëhere se edhe ju vetë nuk i besonit më thelbit tuaj, ndiheshit i turpëruar prej tij. Hë pra, si t'i dinim të gjitha këto atëhere në fillim, kur ju po e luanit aq mirë rolin që ia kishit caktuar vetes? Derisa erdhi ai çast kur filluat ta zbatonit planin tuaj, ta vinit në jetë ëndrrën tuaj të çmendur. Atëhere, pikërisht atëhere, erdhi edhe zhgënjimi ynë. Një zgënjim i tmerrshëm! Ju nuk e kuptoni ç' do të thotë të zhgënjesh njëmijë konviktore, një Konvikt të tërë.

Terezë D., e lodhur dhe e zbehtë në fytyrë, u mbështet në shpinën e kolltukut. Në zyrë ra një heshtje varri. Alfredi ndihej krejt bosh brenda, thua se një forcë e mistershme ia kishte nxjerrë gjithçka prej aty: edhe ajrin, edhe rropullitë, edhe shpirtin (të kalbur, kishte thënë Terezë D.).

– Ju thoni se Konvikti është zhgënjyer prej meje? – e theu heshtjen Alfredi.

– Po. Madje si asnjëherë tjetër.

– Dhe si e shpreh zhgënjimin një Konvikt?

– Duke u bërë edhe më i keq se ç' ishte para se të zhgënjehej.

– Shprehuni më qartë, ju lutem!

– Si të shprehem më qartë?! A nuk e shihni se në ç' gjendje ka rënë Konvikti ynë? Asnjëherë nuk kanë pasur kaq shumë gjah e viktima gjahtarët e konviktoreve sesa këto muajt e fundit...

– Dhe unë qenkam fajtori?

– Po. Mos i harroni ditët e para, kur Konvikti u shndërrua aq shpejt. Në ato ditë, ai ngjasonte më shumë me një manastir murgeshash sesa me një konvikt. Mandej erdhi zhgënjimi dhe manastiri u kthye në han...

– Me sa më kujtohet, pikërisht ato ditë ju futët në Konviktnjë gjahtar?

– Po, është e vërtetë. Ishin ditët kur ende nuk kishte filluar Zhgënjimi i Përgjithshëm, kur shoqet e mia ende s'dinin gjë për planin tuaj të çmendur. Ndërsa unë e kisha nuhatur që atëhere. Dhe me atë akt protestova sipas mënyrës sime, duke dashur të tërhiqja edhe vëmendjen tuaj sa ishit pa filluar zbatimin e planit satanik. Por juve s'kishte se si t'u tërhiqnin vëmendjen çikërrima të tilla, ju ishit i zënë me plane e sulme të mëdha.

Në zyrë ra përsëri heshtja që zgjati më shumë se herët e tjera.

– Tani po largohem, – tha Terezë D. dhe u ngrit nga vendi. – Më duket se u thanë të gjitha.

– Ju lutem, edhe pak, – tha Alfredi, duke e zënë konviktoren nga duart. – A s'mund ta fshijmë të kaluarën? Ne kemi aq shumë gjëra të përbashkëta, edhe unë, edhe ti...

– Është vonë, – e ndërpreu Terezë D. dhe i largoi duart e saj nga të tija. – Është tepër vonë. Unë nuk ndryshoj më nga shoqet e mia të Konviktit, ashtu si edhe ti pak ndryshon për mua nga gjahtarët e konviktoreve.

Alfredi, i verdhë meit, u shemb në kolltuk. Si nëpër ëndërr dëgjoji disa trokitje. Ishte zonjusha Z.

– Zoti kujdestar, janë shfaqur akrepët, si dikur...

– Jashtë! – ulëriti Alfredi, – ti me gjithë akrepët. Jashtë!

Zonjusha Z. doli nga zyra.

Pas saj doli edhe Terezë D.

Alfredi, me duart që i dridheshin, ndezi një cigare.

Akrepët ishin shfaqur krejt papritur thujtë në të gjitha dhomat e Katit të parë të ndërtesës së Konviktit. Dhjetë konviktore dhe një gjahtar, që në ato çaste ishin ndodhur në njërin prej dhomave të Katit të parë, ishin pickuar prej tyre, por fatmirësisht pa ndonjë ndërlikim serioz, për arsye se në këtë periudhë të vitit (në dimër) helmi i akrepëve ishte më pak i efektshëm, d.m.th. më pak i rrezikshëm se kurrë.

Veçse paniku kishte qenë i madh. Të gjitha konviktoret e Katit të parë (më shumë se dyqind) ishin larguar për në katet e mësipërme, duke i mbipopulluar ato. Shfaqja e akrepëve në një periudhë të tillë të pazakontë, kur zakonisht ata strukeshin thellë strofllave të tyre, u argumentua me faktin se Kati i parë ndodhej sipër mensës dhe kuzhinës së Konviktit, çka do të thoshte se ishte shumë më i ngrohtë se katet e tjera. Sidoqoftë Alfredi, që këto kohët e fundit po bëhej gjithnjë e më bestyt, e pa daljen e panatyrshme të akrepëve si një ogur të keq.

Që të nesërmen e njoftimit, ai i inspektoi vetë të gjitha dhomat e Katit të parë, duke vëzhguar jo pa neveri ato kafshëza frikëndjellëse, që ashtu të thara e të pangjyrë (s'mund t'i quajë të hirta, të zeza jo se jo), mbërthyer pas faqeve të mureve, dukeshin si të balsamosura e të fiksuara diku. (Deri para këtij çasti, Alfredi i kishte admiruar akrepët për atë simetri frikëndjellëse të trupit dhe për fuqinë e helmit.)

Në drekë u bë një mbledhje urgjente e Këshillit Drejtues të Konviktit me pjesëmarrjen edhe të Drejtorit të Përgjithshëm. Në fillim u vërejt me kënaqësi se gjendja e dhjetë konviktoreshave të pickuara nga akrepët (gjahtari as që u përmend) paraqitej krejt normale. Shenjat e lehta të frikës e të depressionit, të vërejtura te një numër i madh konviktoresh, u

quajtën më se të natyrshme pas një dukurie të tillë të pashoqe, siç kishte qenë shfaqja masive e akrepëve. Shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Konviktit (me përjashtim të Alfredit, që kishte mendim krejt të kundërt, por të cilin nuk e shprehu) mendonin se frika e depresioni të konviktorët do të ishin kalimtare dhe se shumë shpejt jeta në Konvikt do të hynte në rrjedhën e saj normale. Problemi më delikat, për të cilin u debatua më shumë dhe i cili qëllimisht u la për në fund të mbledhjes, ishte ai i luftës kundër akrepëve. Që kundër akrepëve duhej filluar lufta, madje urgjentisht, u shprehën njëzëri të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të Konviktit, por kur erdhi puna për të përcaktuar mjetet dhe format e kësaj lufte, atëhere filluan debate e diskutime të shumta e që, jo rrallëherë, u kthyen në grindje e fyerje të ndërsjellta. Pas disa orësh debat të pafrytshëm, u përcaktuan dy grupe me numër thuajse të barabartë anëtarësh dhe u kristalizuan dy qëndrime të ndryshme lidhur me mjetet e formën e luftës kundër akrepëve. Grupi i parë (në krye të të cilit u vendos Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve) ishte për një luftë mekanike kundër akrepëve, duke përdorur mjete të thjeshta, të rastit e rrethanore, siç mund të ishin për shembull: gurët, tullat, çekiçët, fundet e shisheve apo të kavanozëve etj. Edhe parimet e kësaj mënyre luftimi paraqiteshin fare të thjeshta e të zbatueshme – vetë anëtarët e Këshillit Drejtues të Konviktit mund të pajiseshin me mjete të tilla rrethanore dhe ta fillonin menjëherë mbyrtjen e akrepëve kudo që ata gjendeshin: mureve, tavaneve e dyshemeve, nëpër korridore, kudo. Por sipas grupit të dytë (në krye të të cilit u vendos zonjusha Z.) ky variant luftimi, megjithëse në vështrim të parë dukej tepër efikas, paraqiste disa mangësi serioze: së pari, po të zbatohej lufta mekanike, atëhere në përfundim të saj mund të bëhej fjalë për mbyrtje të akrepëve dhe kurrsesi jo për shfarosje të tyre, për faktin e thjeshtë se akrepët që ishin shfaqur mureve kishin lënë nëpër strofulla anëtarët e tjerë të familjeve të tyre, – nëse mund të shprehemi kështu – gratë apo burrat, fëmijët e kushërinjtë, d.m.th. të gjithë sojesorollopën, që natyrisht ishte disa herë më i madh në numër se shuma e atyre ekzemplarëve që ishin

shfaqur mureve, dhe që në çdo rast paraqiste një mundësi rreziku, aq më shumë po të kihej parasysh fakti se soji i akrepëve e kishte tepër të zhvilluar ndjenjën e hakmarrjes; së dyti, pas mbytjes së akrepëve, nëpër mure e gjithkund do të mbeteshin shenjat e tyre, që do të përbënin një burim të vazhdueshëm frike e terrori për konviktoret, dhe, së treti, (pikë në të cilën këmbënguli me të madhe zonjusha Z.) njo-llat nëpër mure pas mbytjes së akrepëve do të ishin një shëmtim i vërtetë për mjediset e brendshme të Konviktit.

Pasi paraqiti këto argumente për të rrëzuar propozimin e grupit të parë, grupi i dytë parashtrori variantin e tij që, gjithsesi, dukej më i moderuar, më i kohës dhe më frytdhënës. Grupi i dytë ishte për një luftë kimike kundër akrepëve, duke përdorur preparate nga më të fundit e nga më të efektshmit, dhe që do të garantonin, padyshim, shfarosjen totale të armikut të neveritshëm. Por, sipas grupit të parë, ky variant luftimi, megjithëse dukej më i moderuar dhe më efikas se varianti që ishte propozuar prej tyre, paraqiste disa mangësi serioze: së pari, përdorimi i helmeve të tilla të fuqishme, siç do të ishin ato që do të hidheshin për shfarosjen e akrepëve, do të paraqiste një rrezik të mundshëm edhe për frymorët e tjerë që gjallonin nëpër Konvikt, pa përjashtuar nga ky rrezik edhe konviktoret; së dyti, duke patur parasysh se efekti i këtyre helmeve nuk ishte i atypëratyshëm, s'përjashtohej mundësia që akrepët, në përpjekje për të mbijetuar, ta shtrinin ofensivën e tyre edhe në katet e tjera të Konviktit; së treti, (pikë në të cilën këmbënguli me të madhe Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve) helmet – si ato që duheshin përdorur për shfarosjen e akrepëve – ishin tepër të kushtueshme dhe Konvikti, me fondet që zotëronte, do ta kishte tepër të vështirë, për të mos thënë të pamundur, për t'i përballuar shpenzimet.

Debatet vazhduan deri në mesnatë, por pa u arritur ndonjë zgjidhje përfundimtare. Atëhere u propozua që të dy variantet të hidheshin në votë. Por përsëri nuk u arrit një zgjidhje përfundimtare, sepse numri i votave për të dy variantet ishte i njëjtë. Dikush u kujtua se kishte kaluar mesnata dhe propozoi që mbledhja të mbyllej për të vazhduar të

nesërmen. Dikush tjetër kundërshtoi, duke thënë se problemi ishte tepër serioz dhe se nesër mund të ishte vonë. Vazhduan përsëri debatet. Herë-herë, anëtarët e KDK-së (Këshilli Drejtues të Konviktit) dremisnin paksa në kolltukët e tyre, dhe kur zgjoheshin e kishin të vështirë të ndiqnin fillin e diskutimeve dhe të debateve. Më në fund, kur dremitjet po bëheshin gjithnjë e më të shpeshta e më të gjata, aq sa mund të flitej për një gjumë kolektiv, dikush u kujtua për Alfredin, që gjatë gjithë kohës së mbledhjes kishte qëndruar mënjanë dhe s'kishte folur as edhe një fjalë. Dikush tjetër u kujtua atë çast se Alfredi nuk kishte marrë pjesë as edhe në votimin e zhvilluar pak më parë. Në rrethana të tilla, kur gjithçka në mes të dy grupeve ndodhej në baraspeshë të plotë, qëndrimi i Alfredit bëhej vendimtar për të përcaktuar epërsinë e njërit grup ndaj tjetrit, duke ndikuar kështu edhe në zgjidhjen përfundimtare. Gjithë anëtarët e KDK-së u gjallëruan dhe u kthyen nga ai. Alfredi ndezi një cigare dhe bëri propozimin e tij që i çuditi jo pak anëtarët e të dy grupeve, por që në fund u pranua njëzëri. Thelbi i propozimit të tij (të cilin dikush, më vonë, e quajti darvinian) ishte ky: të hiqeshin të gjitha kurthet e macet që vepronin në Konvikt, me qëllim që t'u lihej fushë e lirë veprimi minjve, të cilët konsideroheshin si armiq të betuar të akrepëve.

Propozimi i Alfredit dha rezultat shumë shpejt: brenda pak ditëve akrepët u zhdukën të gjithë.

Vonë, shumë vonë, kur qëndrimin të tij në Konvikt po i vinte fundi, Alfredi e kuptoi se propozimi që kishte bërë para do kohësh dhe që ishte zbatuar menjëherë, duke dhënë rezultate të shpejta e të shkëlqyera, ai propozim pra, kishte qenë fatal. Nga zbatimi i tij akrepët u zhdukën të tërë, kurse numri i minjve u rrit me një shpejtësi të pabesueshme, aq sa brenda pak kohësh ata u bënë zotër të vërtetë të Konviktit. U vunë përsëri në përdorim kurthet, u rikthyen macet dhe u hodhën helme nga më të fuqishmit e nga më të kushtueshmit, por rezultatet e arritura ishin krejt të papërfillshme; minjtë, që siç duket kishin fituar imunitet ndaj helmeve (për ditë të tëra ishin ushqyer me akrepë), shtoheshin pa i përfilluar ato, duke sfiduar edhe kurthet e macet – armiqtë e tyre tradicionalë. Disa mbledhje të njëpasnjëshme të KDK-së, që vazhduan deri vonë pas mesnate, nuk dhanë kurrfarë rezultati konkret, po të mos marrim parasysh faktin se e gjithë përgjegjësia për gjendjen e krijuar iu ngarkua Alfredit, i cili nga ana e tij as e kundërshtoi dhe as e pranoi akuzën. Edhe një ekip specialistësh që u dërgua nga Drejtoria e Përgjithshme e Konvikteve nuk ndikoi aspak në përmirësimin e gjendjes. Përkundrazi. Duke i parandjerë rrezikun dhe sulmet e njëpasnjëshme që vinin nga shumë drejtime, minjtë u bënë më të kujdesshëm e më të vëmendshëm. Derisa erdhi një ditë kur, me plot gojën, Konvikti mund të quhej i pushuar prej minjve. Ata ishin bërë zotër të vërtetë të tij. Të hirtë e qimafortë, të shëndetshëm e muskulozë, ata bënë ligjin gjithkund: nëpër dhoma e korridore, nëpër biblioteka e salla argëtimi, gjithkund. Konvikti dukej i terrorizuar prej tyre. Më shumë se gjysma e konviktoleve u larguan. Ato që mbetën (një Zot e di se pse) ishin tjetërsuar.

Gjahtarët e konviktoreve, duke përfitur edhe nga gjendja e krijuar, u treguan më aktivë se kurrë. Atë që s'kishin mundur ta bënin për muaj e vite të tëra, tani e realizonin në pak minuta.

Hynin e dilnin pa vështirësi në Konvikt, ditën dhe natën, harbonin sa të mundnin, me kë të mundnin dhe ku të mundnin. Shpeshherë, mbi trupat e lakuriqtë që zhgërryeshin krevateve apo edhe poshtë në dysheme ndalonin minjtë kureshtarë, që tashmë kishin filluar të mësoheshin me skena të tilla. Në këto ditë Alfredi u lodh e u plak sa për njëqind vjet. Herë-herë fliste me vete dhe lëvizte si somnambul korridoreve të Konviktit. Herë-herë e zinte gjumi në këmbë. Konviktoret e tallnin dhe e fyenin, teksa harbonin mu në sy të tij.

Pikërisht në një prej këtyre ditëve, Alfredi propozoi që Konvikti të mbyllej para kohe (edhe një javë kishte mbetur deri në përfundim), propozim ky që u hodh poshtë nga KDK-ja me arsyetimin se një rast i tillë ishte i pashoq në historinë e Konviktit, që nga ngritja e tij e deri më tash.

Në rrethana të tilla, Alfredi kërkoi të jepte dorëheqjen.

Kjo s'iu pranua.

Dukej më logjike që Konviktin ta drejtonte një fantazëm sesa askush.

Sa u shtri në krevatin bashkëshortor, Alfredi ndjeu të dridhura në të gjithë trupin, thua se ishte shtrirë në një varr. Nesër, për të, ishte dita e fundit e punës si kujdestar konvikti. Ndërsa sonte kishte përpara një natë të gjatë e të pagjumë, siç kishin qenë thuajse të gjitha netët e fundit. Pranë kishte gruan, që flinte e qetë, tmerrësisht e qetë dhe e pafajshme. Alfredi ndjeu dhimbje për të: gjatë gjithë vitit as që ishte kujtuar për gruan, i përfshirë në ethe sulmesh e pushtimesh. Papritur ndjeu një dëshirë të unshme ta përkëdhelte shpatullën e saj të zhveshur. Kishte muaj të tërë pa provuar diçka të tillë. Gruaja, e frymëzuar nga kushedi ç'ëndërr, diç foli në gjumë dhe u kthye në shpinë. Drita e zbehtë e hënës shqyente me mundim perdet e rënda të dhomës së gjumit, bëhej e blertë dhe binte pjerrtazi mbi fytyrën e gruas. Alfredi pa me kureshtje se si luante hëna në atë fytyrë, duke ia pohuar vetes se me të vërtetë kishte një grua të bukur. Kushedi sa kohë kishte pa e bërë këtë pohim. Sidoqoftë ai kishte një grua të bukur (pavarësisht nga trillet e hënës) dhe sonte ndjente dëshirë ta përkëdhelte jo vetëm në shpatullën e zhveshur, por dhe në fytyrën e blertë (vetëm sytë aty dukeshin të zinj), në qafën e hollë, në gjoksin e vogël, gjithkund.

Zgjati dorën dhe, pak pa prekur sytë e mëdhenj të gruas, ndeshi në diçka të fortë që tringëlli si qelq. U kujtua se gjithnjë e më shpesh këto kohët e fundit po bëhej rob halucinacionesh dhe qeshi lehtë. Ndezi abazhurin. Dhoma u mbush me dritë të kuqe, ndërsa e blerta në fytyrën e gruas u bë e kafenjhtë. Ajo ndjeu lojën e beftë të dritave në fytyrë dhe përsëri foli diçka nëpër gjumë. Ai përsëri zgjati dorën drejt saj, por përsëri ndeshi në diçka që tringëlli si qelq. U

drodh lehtë. Tash s'bëhej fjalë për kurrfarë halucinacioni: ai ishte zgjuar, pranë kishte një grua të bukur që ishte e tij dhe të cilën ai kishte një dëshirë të çmendur ta përkëdhelte sonte. Kaq. Asgjë më shumë.

Zgjati dorën, më poshtë kësaj radhe, drejt qafës së hollë e të bukur të gruas. Përsëri ajo pengesë e fortë me një tringëllimë si të qelqtë. Alfredi u ngrit si i tërbuar nga shtrati dhe ndezi llampën e madhe. Dhoma u mbyt me dritë të bardhë, ndërsa te fytyra e gruas e kafenjta u bë e verdhë. Ajo flinte pa ndjerë përpëlitjet e dëshpëruara të Alfredit dhe atë betejë të heshtur e egoiste të ngjyrave në fytyrën e saj. Alfredi u vërsul ta puthte atë fytyrë që sonte ishte tmerrësisht e bukur dhe e pafajshme. Balli iu përplas fort për diku, buza e sipërme iu ça dhe mbi gushë iu sajua një rrëkeze gjaku. Por ai sonte kishte vendosur ta puthte atë fytyrë që ishte më e mrekullueshme se kurrë. Do ta thyente e do ta bënte copë e grimë atë mur të mallkuar si prej qelqi. Alfredi mbylli sytë, ngriti grushtin e majtë dhe goditi furishëm. Priti të dëgjonte zhurmën karakteristike të qelqit të thyer, por në vend të saj dëgjoji veç një rënkim të lehtë dhe asgjë tjetër. Hapi sytë me një parandjenjë të llahtarshme. Fytyra e gruas ishte pranë tij, e pajetë, e mbytur në një pellg gjaku përzier me kristale të thyera, ndërsa tek sytë i lexohej një PSE? e zbehtë.

Ora e Madhe ra dymbëdhjetë herë.

Megjithëse kishte fjetur fare pak (vetëm në të zbardhur e pati zënë gjumi), Alfredi u zgjua herët dhe me një ndjenjë të papërcaktuar faji që ia rëndonte frymëmarrjen deri në stërmundim. Njëherë deshi të rruhej, por më pas një veprim i tillë iu duk krejt i kotë. U la, u vesh, puthi ballin e zbehtë të gruas (si e pastroi më parë nga disa cifla të holla qelqi) dhe doli jashtë.

Ishte ditë me diell dhe njerëzit nuk dukeshin të këqinj. Në të vërtetë, Alfredi gjithmonë kishte pasur bindjen se në Mëngjes herët, atëhere kur ende s'i kanë përtypur ëndrrat e natës së kaluar, njerëzit janë të mirë; më pas, me kalimin e orëve, fillojnë e bëhen realistë, d.m.th. të këqinj. Kulmi i ligësisë së tyre (sipas gjykimit të Alfredit) arrin në Mesditë, atëhere kur dielli u rri mbi kokë dhe duket sikur u kërkon llogari. Ndërsa në Muzg (përsëri sipas gjykimit të Alfredit), kur retë përgjaken si buaj të therur, njerëzit bëhen të gjithë të njëllojtë. Njëlloj ecin, njëlloj qeshin, njëlloj mendojnë, njëlloj dashurojnë. Krejt njëlloj, duke u afruar kësisoj me sendet që i rrethojnë...

Tring-tring-tring. Një tringëllimë çelësash e shkëputi Alfredin nga mendimet dhe e kujtoi se për ku qe nisur. Ishin çelësat e Konviktit. Ishte nisur për t'i dorëzuar. Sipas kontratës së nënshkruar një vit më parë.

Hyri pa trokitur në zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Konvikteve.

– O Perëndi, sa jeni plakur! – i tha zoti C.

– Konvikti është i çuditshëm, – kujtoi Alfredi fjalët që i kishte thënë krejt në fillim rojtari plak, – të riun e bën fëmijë, ndërsa plakun e vdes. Kurse mua, që isha diku në mes, më plaku.

Drejtori i Përgjithshëm i Konvikteve nuk diti ç'të thoshte. Alfredi hodhi çelësat mbi tryezë dhe doli jashtë.

Orët e para të Mëngjesit kishin kaluar dhe njerëzit e shikonin me dyshim njëri-tjetrin.

Alfredi ndjeu papritur një dëshirë gërryese për t'u mbyllur në studio dhe për të punuar.

Shkodër, dhjetor 1994

BOTIME
ÇABEJ MÇM

VERBA MUNDI

1. Eqrem Çabej *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, eseistikë
2. Gabriel Partos *Bota që erdhi prej të ftohtit*, histori bashkëkohore

KONSTELACIONE

1. Fatos Kongoli *Kufoma*, roman
2. Helena Kadare *Një grua nga Tirana*, roman
3. Ismail Kadare *Piramida*, roman
4. Ridvan Dibra *Nudo*, roman

LLAMPA MAGJIKE

1. Charles Perrault, *Zonja d'Aulnoy E bukura e pyjeve*, përralla
2. Pierre Gripari *Përrallat e rrugës «Broka»*, përralla



Konstelacione 4

...Dibra ka një dorëshkrim dhe mjeshtëri prozatori nga më brilantet në letrat shqipe.

Shkëlzen Maliqi, *Zëri*

...mbasi ke lexuar Ridvan Dibrën është tepër e lodhshme, për të mos thënë e pamundur, të mendosh në mënyrë të virgjër për jetën, dashurinë, martesën, Zotin.

...Ky art është as më shumë as më pak një Art i Revoltës... i një Revolte shumëdimensionale, që shkatërron për të ndërtuar.

Ardian Marashi, *Hylli i Dritës*

Ridvan Dibra ka lindur në Shkodër më 9 janar 1959. Është rritur e shkolluar në qytetin e lindjes, ku u diplomua për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin Luigj Gurakuqi më 1982. Ka punuar arsimtar në Kukës ('82-'87) e gazetar në Shkodër ('88-'94). Deri më sot ka botuar vëllimet *Thjesht* (poezi, sh. b. Naim Frashëri, 1989), *Prostituta e virgjër* (tregime, sh. b. Idromeno, 1994) dhe *Eklipsi i shpirtit* (tregime, sh. b. At Gjergj Fishta, 1994). *Nudo* është romani i tij i parë.